

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7794 E premte 15 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Në shërbimin e jashtëm të BE-së irritohej kur u thuhet se ata po mbështesin ndarjen e Kosovës dhe ndryshimin e kufijve. Pohojnë se ata "nuk mbështesin ..."

Vijon në faqen 20

Nga AUGUSTIN PALOKAJ

Marrëveshja me ndryshim kufijsh mund të na largojë nga BE



Opinion i Ditës

Ka shumë pikëpyetje lidhur me faktin ekstrem të Edi Palokës për të goditur me bojë stilografinë në fytyrë kryeministrin e vendit. Përtej gëzimit të atyre ...

Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

A i njolloset më fytyra Ramës?



Policia: Kufizojmë vendin e protestës

Basha: Do të hapim derën e Europës. Kryemadhi: Protestë e gjithë shqiptarëve

Më 16 shkurt tubim para kryeministrisë, Rama ikën në Vlorë. Lleshaj: Si Gruevski

Nga VALENTINA MADANI

Partia Demokratike akuzon Policinë e Shtetit se po vepron nën urdhrat politikë të Edi Ramës, i cili i frikësuar nga bashkimi popullor, po ndjen vetminë e tij politike. Policia e Tiranës ka refuzuar lejen për protestë pa afat të Partisë Demokratike ...

Në faqen 4

INCIDENTI NE SEANCE, EDI PALOKA ME SHIRINGE NE DORE: S'KE PARE GJE AKOMA

RAMA SPERKATET ME BOJE, TENSION PARA PROTESTES

Kryeministri: Me bojëra jam mësuar, nuk i hap rrugë budallallëkut. PD: Mospranim i bullizmit. Balla: Të shkarkohet si nënkryetar i Kuvendit. Garda: Solucion kimik



(Në foto) Deputeti i PD, Edi Paloka duke i hedhur bojë Kryeministrit, Edi Rama, gjatë seancës së djeshme parlamentare



Në faqen 3

SHENDETESI

Zgjidhen 32 shefa të rinj në QSUT. Zhgënjehen mjekët, bëjnë gati paditë

Në faqen 6

EMIGRIMI

Lotaria Amerikane, ambasada: Çfarë nevojitet të dinë fituesit e DV-2019

Në faqen 6

SHUMICA SHQIPTARE

14 të vdekur në aksidentin në rrugën Shkup-Gostivar, Zaev: Dhimbje e pikëllim

Në faqen 16

"S'NGACMOVA ASKEND"

Videoja lakuria, polici shtafjësohet në gjyq: S'di ta përdor celularin

Në faqen 7

6 GRA TE VRARA NE 2019



Vritet me 3 plumba në kokë nëna e 4 fëmijëve, në kërkim kunati

Në faqen 8-9

Ndërtimet pa leje, fondi 5 milionë USD për pagesën e tokës së zënë nga "informalët"

Lista e dytë, 750 pronarët që marrin paratë

Emrat e përfutuesve në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë e Vlorë

Qeveria miraton kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi i vënë në dispozicion është rreth 552 milionë lekë. ALUIZNI publikon listën me 753 pronarë që përfitojnë fondin e miratuar dhe. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në drejtoritë për ALUIZ-



NI-t, përkatësisht në Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Kavajë, Fshatra Turistikë dhe Kamëz, Vorë. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, vlera e kompensimit për 43 920,53 m2 është 522 842 426,65 lekë...

Në faqen 10-13

SEANCA PLENARE INCIDENTI

Basha: Në pushtet prej kriminelëve, derën e Europës do ta hapim me protestë

PD: Gjuajtja me bojë, mospranim i bullizmit të ushtruar nga Rama

Kryemadhi: Kryeministri rrugaç bullizon, deficencë mendore

Valentina Madani

Partia Demokratike publikoi dje një video, duke thënë se veprimi i sulmit me bojë i Edi Palokës ka lidhje me atë që ajo e quan si bullizëm të kryeministrit ndaj nënkryetarit të partisë. Sipas PD-së, qëndrimi i deputetit demokrat erdhi për shkak të talljes së vazhdueshme që Rama i bëri në seancat e kaluara. "Edi Paloka e gjuajti me bojë Edi Ramën, pasi ky e talli në mënyrë të përsëritur, për shkak të mënyrës së të folurit. Gjuajtja me bojë është mospranim i bullizmit të ushtruar nga kryeministri për të cilin është dëshmitar i gjithë opinion publik", thuhet në deklaratën e PD-së. Ndërsa në Kuvend, dje kreu i opozitës Lulzim Basha paralajmëroi: "Ditën e shtunë përballja është e qartë. Matanë gardhit të policëve është kryehajduti i kapur në vjedhje. Përballë është populli i vjedhur. Derën e Europës do ta hapim të gjithë bashkë në protestën e 16 shkurtit".

etarja e LSI, Monika Kryemadhi, në përfundim të Kuvendit akuzoi kryeministrin Rama për bullizëm. Jashtë parlamentit, ajo i shpreh se Rama bullizon jo vetëm qytetarët, por edhe deputetët dhe ministrat. "Vjen një moment që të gjithë jemi njerëz, të gjithë kemi momentet tona të emocioneve, por e

disata herë që ky kryeministër rrugaç ka bullizuar shqiptarët në radhë të parë duke i konsideruar me organe gjenitale, me pas vazhdon dhe bullizon deputetët në parlament, bullizon ministrat e tij", deklaroi kryetarja e LSI-së. Kryemadhi kishte dhe një propozim: "Ka pasur Shqipëria në 27 vjet kryemi-

nistra, por kurrë nuk kemi pasur kryeministër qesharak që krijon incidente të tilla papërgjegjshmëri dhe mbi të gjitha një deficencë mendore. Duhet t'i bëjmë një propozim parlamentit që të gjithë ata që marrin poste drejtuese që nga presidenti deri te ministrat duhet të bëjnë analizën psikike dhe klinike". Ndërsa, referuar protestës së 16 shkurtit, kryetarja e LSI-së tha se ajo është protesta e gjithë shqiptarëve. Ndërsa u shpreh se e vetmja zgjidhje politike është qeveria kalimtare. "Protesta është e gjithë shqiptarëve. Unë jam e bindur që dhe ju gazetaret do jeni në protestë. Ju para disa kohësh patë plumbat në shtëpinë e një gazetares. Çdo ditë e më shumë do të shikojmë një reagim kriminal të një njeriu në ilke që është i cmendur: Zgjidhja politike është e qartë, ajo që ka propozuar opozita në marrëveshjen e saj, qeveri kalimtare që u krijon shqiptarëve zgjedhje të lira dhe të ndershme", u shpreh zj. Kryemadhi.



Seanca e djeshme parlamentare



Kreu i opozitës Lulzim Basha, dje në parlament

Përballja



LULZIM BASHA

"Ditën e shtunë përballja është e qartë. Matanë gardhit të policëve është kryehajduti i kapur në vjedhje. Përballë është populli i vjedhur. Derën e Europës do ta hapim të gjithë bashkë në protestën e 16 shkurtit", tha z.Basha. Protesta e opozitës do të nisë të shtunën në orën 11:00, ndërsa Basha bëri të qartë se nuk do të ketë kthim pas pa largimin e Edi Ramës.

Incidenti, Berisha: Një përgjigje me mosbindje civile, sharësit të lindur

Ish-kryeministri Sali Berisha e vlerësoi si "një përgjigje lme mosbindje civile, sharësit të lindur", incidentin që ndodhi sot në Kuvend bojtisjen e fytyrës së kryeministrit Edi Rama nga nënkryetari i parlamentit, demokrati Edi Paloka. Berisha, në një prononcim për mediat jashtë sallës së Kuvendit, shpjegoi edhe arsyet e sulmit me bojë ndaj kryeministrit Edi Rama. Por, ish-kryeministri mohoi që Paloka të ketë qëlluar me shiringë, duke thënë se ishte një stilograf, edhe pse vetë fotot e shpërndara nga zyra e shtypit të PD-së dëshmojnë të kundërtën. "Basha nuk i bëri asnjë fytyrë personale, përveçse se i tha ato që ia thotë çdo shqiptar, kurse ai u lëshua me gojështrujen e tij, me fjalë të cilat ishin ofenduese", u shpreh z.Berisha. Ish-kryeministri dhe lideri historik i së djathtës tha se kjo sjellje e kreut të qeverisë duhet të marrë fund. "Duhet të marrë fund një herë e mirë ofendimi me sharje, sepse është një sharës i lindur ai, nuk ka kusure opozita. Ku e dini ju, mori bojë apo ishte stilografi? Se ju po bëni edhe detektivin tani. Ai mund të kishte një stilograf me vete. Se mos ngatërro stilografim me shiringën... Nuk ka gjë më të rëndë se kur kreu i qeverisë në çdo dalje publike shan opozitën, kjo nuk ndodh askund në botë, vetëm në Venezuelë ndodh kjo me Maduron", tha Berisha.



Veliaj: Përdhosje e çdo vlere shqiptari

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, komentoi incidentin e ndodhur dje në Kuvend, para nisjes së votimit për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, ku nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka hodhi bojë drejt kryeministrit Rama. Kryebashkiaku i quajti deputetët e opozitës neandertalë të SHQUP, që i nxorën bojnë këtij vendi. "Neandertalët e SHQUP, mavri me bojë që i nxorën bojnë këtij vendi me dhunë. Neandertalët e SHQUP, shkatërrim e përdhosje të çdo vlere shqiptari! Turp!", tha Veliaj.



Edi Paloka, bojë fytyrës së Ramës, Garda: Ishte solucion kimik

Garda e Republikës deklaroi dje se ka nisur hetimet ndaj Edi Palokës, pasi pretendimet janë që boja brenda shiringës që nënkryetari i Kuvendit zbrazi ndaj kryeministrit Rama të jetë një solucion kimik. "Sot, (dje) në sallën e seancave të Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Edi Paloka ka sulmuar me një solucion kimik të parapërgatitur kryeministrin e Shqipërisë, z. Edi Rama. Garda e Republikës me mbështetjen e strukturave të specializuara të Policisë së Shtetit ka nisur hetimet e menjëhershme për agresionin e kryer në sytë e të gjithëve dhe gjithashtu procedimin penal kundër shtetasit Edi Paloka", thuhet në deklaratën e Gardës.



Valentina Madani

Seanca e djeshme plene re ishte lajmëruar si seancë solemne për ratifikimin e protokollit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, por përfundoi në një tjetër seancë tensionesh mes mazhorancës dhe opozitës. Për nder të kësaj ceremonie ishte i ftuar edhe kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferri, por ky i fundit u bë dëshmitar i përplasjeve të politikës së brendshme në Tiranë. Opozita ndezi situatën në Kuvend teksa nënkryetari demokrat i PD-së, Edi Paloka, hodhi një shiringë me bojë ndaj kryeministrit. Ajo që tensionoi situatën ishte reagoni i kryeministrit pas fjalës së Lulzim Bashës, i cili u ngrit të përshëndeste vendimin për anëtarësimin e fqinjët tonë në Aleancën e Atlantikut të Veriut dhe përfundoi me thirrje për pjesëmarrje masive në protestën e 16 shkurtit për të rrezuar qeverinë, të cilën e quajti si më të inkriminuarën e rajonit.

BALLA

REPLIKAT

Pas kryeministrit Edi Rama, i cili mbajti fjalën e rastit për votimin e protokollit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, në foltore doli kryetari i PD-së, Lulzim Basha, i cili përshëndeti Maqedoninë. Duke iu drejtuar Xhaferri, të ulur në lozhë tha: "Skenari i Maqedonisë së Veriut deri para pak kohësh është shumë më i lehtë se ai ku gjendim sot dhe ky është mortali i dytë në të cilën merr pjesë kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferri, mortali i rënies së shtetit ligjor dhe demokracisë në Shqipëri. Parlamentit është i mbushur me njerëz që kanë ardhur këtu si shprehje e vullnetit të bandave, të krimin të organizuar, të një grushti oligarkësh, që kanë kapur qeverinë dhe e kanë detyruar të braktisë dhe tradhetojë interesin publik dhe detyrimet ndaj BE-së. Këto janë arsye pse ne nuk mund të festojmë me fqinjët tanë, ndonëse na bëhet qejfi, kur dëgjojmë miqtë tanë se jeni gatë të merrni dritën jeshile për hapjen e negociatave, por me siguri edhe ju e dëgjoni se frika e tyre është se këtë qershor Shqipëria nuk mund dhe nuk do ta marrë hapjen e negociatave". Menjëherë pas tij, Rama mori fjalën. Duke iu drejtuar Talat Xhaferri, tha: "dashur mik, ju kërkoi ndjesë për këtë shkelje të kodit të mikpritjes, por dua t'ju siguroj që femi sapo foli jo vetëm që nuk i mendon ato që thotë, por nuk di se çfarë thotë".

INCIDENTI

Nuk kaluan disa minuta dhe ndërsa në foltore po priste të fliste kreu i PR-së, Fatmir Mediu, deputeti

Incidenti në prani të Xhaferri, nga sulmi me shiringë të "plehrë" dhe "qelbësirë"

Tension në Kuvend, Paloka e spërkat me bojë. Rama: Zorzop

"Me bojëra jam mësuar, s'i hap rrugë budallallëkut"

EDI RAMA

"Dy gjëra janë të pafundme, universi dhe budallallëku i njeriut", shkruante Albert Ainshtajni, përpara se sa opozita në Shqipëri të merrte formën e një budallallëku universal, që vizon ka vezën e Lulit, ide ka çizmen e doktoreshës dhe program ka bojën e Palothës", u shpreh Rama.



Momenti i incidentit dhe në parlament

FATMIR XHAFAJ

"Një TURP kjo që ndodhi në Kuvend. Një akt që na fyen të gjithëve, por që turpëron rëndë frymëzuesit, nxitësit e zbatuesit e kësaj shfaqje të turpshme për Kuvendin dhe imazhin e vendit. Bërë kjo, në prani të mysafirëve të nderuar në Kuvendin e Shqipërisë, për të nderuar momentin historik të anëtarësimit në NATO të fqinjët lindor, i bën nxitësit e ekzekutuesit e aktit, me TURP para gjë gjithë shqiptarëve. Këtëj e andej kufirit", shkruan Xhafaj.

Byroja e përjashton 10 ditë nga Kuvendi

Paloka: Boja ishte fillimi i 16 shkurtit, Rama s'ka parë gjë akoma

Byroja e Kuvendit për jashtëoi dje me 10 ditë nga seancat plenare deputetët e PD-së, Edi Paloka. Vendimi i Byrosë erdhi pasi Paloka i hodhi bojë në fytyrë kryeministrit Edi Rama gjatë seancës së djeshme parlamentare, ku i pranishëm ishte edhe kreu i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferri. Reagoni i Palokës erdhi pas fjalës së Bashës, si dhe republikës së Ramës. Kryeministri i kërkoi falje Talat Xhaferri për sjelljen e Bashës, duke e quajtur "fëmijë, që nuk di çfarë bën dhe çfarë flet. "Ju kërkoi ndjesë për këtë shkelje të kodit të mikpritjes, por femi sapo foli jo vetëm që nuk i mendon ato që thotë, por nuk



di edhe çfarë thotë", tha Rama, që solli irritimin e deputeteve të opozitës. Nënkryetari i Kuvendit dhe PD-së, Edi Paloka, sulmim me bojë ndaj kryeministrit Rama e quajti "vetëm fillim të 16 Shkurtit". I pyetur nga gazetarët jashtë ambienteve të parlamentit nëse po

paralajmëronte trazira, Paloka tha: "Thojni që s'ka parë asgjë akoma". Paloka bëri të qartë se nuk ishte hakmarrje e tij personale ai veprim, por fillimi i 16 shkurtit dhe kryeministri nuk ka parë gjë akoma. "Nuk na përjashton Gramozi. Ai parlament është përjashtuar nga populli. Është parlament me vota të vjedhura. Pashë disa komente që u hakmor Paloka, nuk ishte hakmarrje e Palokës, ishte hakmarrje e shqiptarëve, që çdo ditë fihen e vidhen nga një qeveri dhe kryeministër arrogant dhe i pacipë. As më bëhet vonë fare. Është vetëm fillimi i 16 shkurtit, thojni që nuk ka parë realisht asgjë akoma", - tha Paloka.

demokrat u ngrit nga karrigia e tij dhe iu afrua Ramës, duke i zbratur në fytyrë shiringën, të cilën e kishte të mbushur me bojë. Një nga punonjësit e Gardës kur pa se Paloka po i afrohej kryeministrit, vrapoi ta ndalonte, por ishte e pamundur, pasi e gjitha ndodhi shpejt. Më pas u afruan gardistë të tjerë, të cilët janë munduar ta largojnë Palokën. Ruçi urdhëroi përjashtimin e Palokës, por meqë ai nuk largohej nga salla, ndërpreu se-

ancën. Më pas u mblodh Byroja dhe vendosi përjashtimin e Palokës nga Kuvendi me 10 ditë. Paloka nuk iu bind kërkesës së kryeparlamentarit Ruçi për të lënë seancën. Ai reagoi po në të njëjtën linjë nga selia e Partisë Demokratike. Veç përjashtimit, Garda e Republikës lajmëroi se me mbështetjen e policisë ka nisur një hetim për agresion, duke sqaruar se solutioni kimik ka qenë i parapërgatitur. Veprimi i Palokës e gjeti të papërgati-

tur kryeministrin i cili, në çastet e tensionit në seancë është drejtuar Palokës me fjalët "plehrë", po ashtu e nevrikosur me kolegun deputet, kundërshtar politikë, ministria Spiropali e quan atë "qelbësirë", "s'ka turp" lexohet në mimikën e saj.

REAGIMI

Kryeministri Rama reagoi vetë disa herë në rrjetet sociale, duke postuar shiringën e përdorur për bojën, videon dhe duke ironizuar serish Palokën për prob-

lemet me shqiptimin. "Dy gjëra janë të pafundme, universi dhe budallallëku i njeriut", shkruante Albert Ainshtajni, përpara se sa opozita në Shqipëri të merrte formën e një budallallëku universal, që vizon ka vezën e Lulit, ide ka çizmen e doktoreshës dhe program ka bojën e Palothës...", deklaroi z.Rama. Kryeministri reagoi sërish pas sulmit që deputeti Paloka i bëri me një shiringë me bojë. Në "Twitter", Rama shkruan: "Flm për mesazhet e solidaritetit, po s'më shqetëson hiç boja se me bojërat jam rritur e mësuar. Më shqetëson mendja e shpirti katran i palopërfaqësuesve të një populli që s'i meriton këta zorzopë. Prandaj jo që s'i hap rrugë budallallëkut, po veç më rritet pasioni e vendosmëria". Ndërkohë që më pas, Rama publikoi në "Instagram" edhe shiringën, me të cilën Paloka e spërkat me bojë. Ironia edhe këtu nuk mungon: "Penda e mendimtarit E.Th.Palotha pas një dhjetë ditësh të fuqishme mendimesh mbi rolin e opozitës në zhvillimin e vendit", - shkruan Rama. Por, PD publikoi një video tjetër, duke thënë se veprimi i Palokës ka lidhje me atë që ajo e quan si bullizëm të kryeministrit ndaj nënkryetarit të partisë. "Edi Paloka e guajti me bojë Edi Ramën, pasi ky e talli në mënyrë të përsëritur për shkak të mënyrës së të folurit. Guajtia me bojë është mospranim i bullizmit të ushtruar nga kryeministri, për të cilin është dëshmitar i gjithë opinion publik". Mazhoranca reagoi duke thënë se do të marrë masa të tjera në Kuvend.



Kërkesë për shkarkimin e Palokës si nënkryetar i Kuvendit

Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla bëri dje të ditur se PS-ja do deponojë kërkesë për shkarkimin e Edi Palokës si nënkryetar i Kuvendit, pas veprimeve të tij në Kuvend. "PD kryen atë akt të turpshëm në sy të Talat Xhaferri. Gjithçka u bë në një seancë solemne si është momenti i votimit të marrëveshjes për anëtarësimin në NATO të Maqedonisë së Veriut dhe në prezencën e një mikru të vyer jo se është kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, por se është personalitet i rëndësishëm i shqiptarësisë. Berisha ia ka marrë dorën që çadrën ta bëjë pistoletë dhe shiringën ta bëjë stilograf. Të bëhen hetimet për turpin që kreu nënkryetari i Kuvendit. Garda të bëjë hetimet e veta për turpin që bëri nënkryetari i Kuvendit. Ne do të deponojmë kërkesën për shkarkimin e Palokës si nënkryetar i Kuvendit", - tha Balla.

PROTESTA PERPLASJA

Zbardhen 4 korrespondencat. PD protesta në bulevard, te Piramida dhe I.Qemali

Përplasia, policia refuzon lejen e PD-së për protestën e 16 shkurtit

PD: Jo policia, qytetarët vendosin për vendin e protestës

Valentina Madani

Partia Demokratike akuzon Policinë e Shetit se po vepron nën urdhrat politikë të Edi Ramës, i cili i frikësuar nga bashkimi popullor, po ndjen vetminë e tij politike. Policia e Tiranës ka refuzuar lejen për protestë pa afat të Partisë Demokratike. Sella blu në kërkesën drejtuar policisë kërkonte që leja për tubim, që nis në orën 11:00 të jetë pa një afat të përcaktuar se kur do të mbarojë. Por, kërkesa është kthyer me argumentin që të specifikohet orari se kur do të mbyllet tubimi para selisë së qeverisë, ndërsa lë afat orën 24:00 të së shtunës. Ndërkohë që një tjetër problem në kërkesën për leje të dorëzuar nga PD-ja janë edhe koordinatat. PD kërkoi leje për protestën në katër rrugët që rrethojnë Kryeministrinë, bulevardin "Dëshmorët e Kombit" të sheshi para Kryeministrisë, lulishtja te Piramida dhe te rruga "Ismail Qemali" në krah të Kryeministrisë. Duke iu përgjigjur interesimit të medias, PD theksoi dje përmes një deklaratë se policia nuk ka asnjë autoritet ligjor për të vendosur vendin e zhvillimit të protestës. Reagimi erdhi pasi "News 24" zbardhi 4 korrespondenca dhe replikat mes Partisë Demokratike dhe Policisë së Tiranës për zhvillimin e protestës së 16 shkurtit para godinës së Kryeministrisë. "News 24" ka siguruar kërkesën e opozitës bërë nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm, Gazmend Bardhi, që njofton policinë se protesta do të zhvillohet në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" tek sheshi para Kryeministrisë, lulishtja tek Piramida dhe te rruga "Ismail Qemali" në krah të Kryeministrisë, rrugë në të cilën mjetet lëvizin nga RTSH-ja drejt bulevardit. Partia Demokratike reagoi pas vendimit të Policisë së Shtetit për të mos lejuar opozitën që të kryejë tubimin më 16 shkurt, në



Lleshaj: Skenari i opozitës, njësoj me skenat e Gruevskit në 2017-ën

Ministri i Brendshëm, Sander Lleshaj, e krahasoi situatën e djeshme në Kuvend me atë të parlamentit të Maqedonisë në 2017-ën. Në një status në "Twitter", Lleshaj thotë se opozita bëri atë që ish-kryeministri Gruevski bëri në Kuvendin e FYROM në prill të 2017-ës. "Përpjekja e sotme ishte shumë e ngjashme me ato skena që krijoi Gruevski në Kuvendin e FYROM në prill të 2017-ës, në bashkëpunim të ngushtë me kumbarët atlantikë nga Lindja. Maqedonia e Veriut në NATO është interes edhe i Shqipërisë. Përpjekja e opozitës për të njoftuar solemnitetin atlantik të një vendimi në Kuvend, është turp dhe dëshpërim. Asgjë nuk e ndalon vullnetin e njerëzve të lirë të Ballkanit për t'u bashkuar në NATO dhe BE. Urime për Maqedoninë e Veriut", deklaroi z. Lleshaj. Por deputeti demokrat Flamur Noka reagoi dje deklaratave të ministrit të Brendshëm, Sander Lleshaj, i cili i krahasoi aktet e opozitës si shumë të ngjashme me ato skena që krijoi Gruevski në Kuvendin maqedonas në prill të 2017. Sipas Nokës, Lleshaj po përdoret si manekin nga Rama. Të cilit, siç tha Noka me ironi, Lleshaj i ka dhënë edhe 'password'-in e trurit. "Kur të emëruan, të shtitën si pasardhës i Kadaresë ty z.Lleshaj, por shpejt të doli kalaja i dole pasardhës i Geron Xhafajt 'password'-in e 'Twitter'-it ia ke dhënë Ramës. Po na rezulton që je në rolin e manekinit dhe i kë dhënë dhe 'password'-in e trurit", - shprehet Noka në "Facebook".

sheshet dhe vendkalimet publike, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", sheshi përpara Kryeministrisë, lulishtja tek Piramida dhe rruga "Ismail Qemali". Duke iu përgjigjur interesimit të medias mbilajmin e shpërndarë në lidhje me protestën, PD sqaron: "Në përpunim me Ligjin për Tubimet, Partia Demokratike ka njoftuar Po-

licinë e Shtetit për zhvillimin e tubimit më datë 16 shkurt 2019, ora 11.00, në sheshet dhe vendkalimet publike bulevardit "Dëshmorët e Kombit", sheshi përpara Kryeministrisë, lulishtja te Piramida dhe rruga "Ismail Qemali". Policia e Shtetit, në kundërshtim me ligjin dhe për arsye politike, ka njoftuar ndryshimin e vendit të protestës,

POLICIA
Policia e Tiranës ka refuzuar lejen për protestë pa afat të Partisë Demokratike. Sella blu në kërkesën drejtuar policisë kërkonte që leja për tubim, që nis në orën 11:00 të jetë pa një afat të përcaktuar se kur do të mbarojë. Por, kërkesa është kthyer me argumentin që të specifikohet orari se kur do të mbyllet tubimi para selisë së qeverisë, ndërsa lë afat orën 24:00 të së shtunës

Opozita protestë në Tiranë, Rama të shtunën në Vlorë

Tëksa të shtunën pritet të zhvillohet protesta e opozitës në Tiranë, kryeministri Edi Rama duket se do të vijojë axhendën normale të takimit. Kreu i qeverisë do të jetë në Vlorë. Të pakten kështu bën me dije ish-ministri i Transporteve, Damian Gjiknuri, i cili shkruan se të shtunën bashkë me Ramën do të jetë në Vlorë, në kuadër të takimeve publike "Bashkia që duam". "Në kuadër të takimeve publike të turit 'Bashkia që duam', kryeministri Edi Rama do të jetë të shtunën në qytetin e Vlorës. Vëmendja e shtuar e qeverisë për qarkun e Vlorës tashmë është e prekshme përmes investimeve të kryera dhe projekteve të planifikuara. Ptojt të gjithë qytetarët të jenë në orën 10:30 në sheshin e 'Flamurit', shprehet z.Gjiknuri. Po ditën e shtunë në orën 11:00 do të nisë protesta e opozitës.

duke mos lejuar zhvillimin e saj edhe te lulishtja te Piramida dhe Rruga 'Ismail Qemali'. Sipas ligjit, policia nuk ka asnjë autoritet ligjor për të vendosur vendin e zhvillimit të protestës. Partia Demokratike nuk pret leje nga Policia e Shtetit për zhvillimin e tubimit, sepse ajo është një e drejtë kushtetuese e opozitës dhe qyteta-



Shqipëria ratifikon protokollin për Maqedoninë e Veriut në NATO

Kuvendi i Shqipërisë është ndër të parët parlamentet që ratifikoi Protokollin e Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO. Pas një minutë heshtjeje për viktimat e aksidentit tragjik në Maqedoni, debateve për politikën e brendshme dhe incidentit mes deputetit demokrat Edi Paloka dhe kryeministrit Edi Rama, parlamenti miratoi unanimisht protokollin për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO. Në fjalën e mbajtur para deputetëve shqiptarë, kryeparlamentari i Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferrri, u shpreh se rruga drejt këtij momenti ka qenë e vështirë, por politikanët zgjodhën të ardhmen e sigurt. "Nuk hezitua në asnjë moment, sepse qytetarët tanë meritojnë të jenë të lumtur me të drejta liri të barabarta dhe standarde europiane", tha z.Xhaferrri. Kryeministri Edi Rama e cilësoi një arritje e përbashkët mes shqiptarëve dhe maqedonasve të veriut. "Pa shqiptarët s'do të kishte Maqedoni të Veriut dhe për Shqipërinë, integriteti territorial i Maqedonisë së Veriut, bashkëjetesa e vërtetë demokratike mes dy popujve tanë në territorin e republikës fqinje dhe gjuha shqipe në atë territor janë jo vetëm të pacenueshme, por edhe jetike për të sotmen e të ardhmen tonë dhe të paqes e të stabilitetit në rajon gjithashtu, por roli ynë në këtë proces historik ka qenë sidoqoftë një rol mbështetës dhe jo një rol udhëheqës", - tha Rama. Nga ana e tij, z. Basha u shpreh se faktori politik në vendin fqinj tregoi vizion dhe maturi. "Është meritë e madhe e të gjithë faktorit politik të fqinjit tonë dhe faktorit politik shqiptar, i cili kurrë nuk u lëkund nga kthjelltësia e prioritetëve", deklaroi kreu i PD-së.

rëve. Kjo është arsyeja se përse ligji parashikon njoftimin e policisë dhe jo kërkesën për leje. Qëndrimi i Partisë Demokratike i është bërë i njohur zyrtarisht Policisë së Shtetit, duke i kujtuar se ka përgjegjësi ligjore për të siguruar mbarëvajtjen e protestës, në vendet e njoftuara nga Partia Demokratike. Policia e Sh-



titit po vepron nën urdhrat politikë të Edi Ramës, i cili, i frikësuar nga bashkimi popullor, po ndjen vetminë e tij politike. Duke garantuar qytetarët për protestën e 16 shkurtit, Partia Demokratike ka marrë të gjitha masat për sigurinë e protestuesve dhe ushtrimin prej tyre në mënyrë të ligjshme dhe pa asnjë pengesë".



Një nga protestat e opozitës

Valentina Madani

Ndërkombëtarët ape luan dje për shmangien e dhunës në protestën që organizon opozita me 16 shkurt kundër qeverisë "Rama". Ambasada amerikane në Tiranë bëri dje thirrje për një protestë paqësore të shtunën e 16 shkurtit në Tiranë. Në një deklaratë në rrjetet sociale, ambasada amerikane tha se, "e drejta e qytetarëve për t'u mbledhur, për t'i bërë kërkesa qeverisë dhe për të protestuar për ndryshim pozitiv janë simbole të një shoqërie demokratike të lirë dhe të shëndetshme. Është një e drejtë që ushtrohet shpesh në Shtetet e Bashkuara". Por, ambasada tha se kjo e drejtë duhet ushtruar paqësisht. "Megjithatë, kjo e drejtë duhet ushtruar paqësisht. Dhuna kundër njerëzve ose pronës është e papranueshme. Ne iu bëjmë thirrje të gjithë atyre që janë përfshirë në protestën e së shtunës dhe të gjithë udhëheqësve politikë shqiptarë, të refuzojnë dhunën dhe të sigurohen që protestat të zhvillohen paqësisht dhe në mënyrë konstruktive", thuhet në deklaratën e ambasadës së SHBA-ve në Tiranë. Ndërsa, ambasadori i delegacionit të BE-së në Shqipëri, Luigi Soreca, në një intervistë për "DW" bëri thirrje për një manifestim paqësor: "Ky është një moment me rëndësi për Shqipërinë në

Presidenti i PPE-së: Shqetësuese, gjendja e demokracisë në Shqipëri

SHBA, thirrje opozitës: Protestë paqësore, refuzoni dhunën

Soreca: Manifestim paqësor, jo dhunë më 16 shkurt



Ambasada amerikane në Tiranë



OSBE

"Shprehim shpresën tonë që protesta politike e së shtunës nuk do të degjenerojë në dhunë. Aspiratat e të gjithë qytetarëve shqiptarë kërkojnë një diskurs politik të pjekur dhe konstruktiv; trazirat nuk janë një rrugë e shkurtër për të ardhur në pushtet", shprehet ambasadori i OSBE-së, Bernd Borchardt.

kuptimin që e drejta e tubimit, e drejta e fjalës janë një pjesë thelbësore e çdo shoqërie demokratike. Por, është gjithashtu e vërtetë që këto të drejta duhet të ushtrohen në mënyrë paqësore. Prandaj presim një manifestim paqësor që të mos kthehet në dhunë. Kjo është një thirrje

për të gjitha palët e përfshira. Është e rëndësishme që të gjithë të jenë konstruktivë", deklaroi z.Soreca. Sipas ambasadorit të BE-së, "dhuna nuk do t'i lejojë ata që dëshirojnë të flasin që zëri i tyre të dëgohet. Ndaj thirrja ime është për ta: Flisni pa dhunë dhe mesazhi juaj do të dëgohet",

u shpreh z.Soreca. Thirrjes për një demonstratë paqësore iu bashkua edhe ambasadori britanik në Tiranë, Duncan Norman. "Mbretëria e Bashkuar e konsideron të drejtë për të protestuar si një e drejtë demokratike themelore. Megjithatë, demonstrimet duhet të jenë paqësore, në

gofte se ata janë për të mbështetur demokracinë", tha z.Norman. Edhe presidenti i Partisë Popullore Europiane, Joseph Daul, reagoi në "Twitter" lidhur me situatën në Shqipëri. Daul shkruan se është shumë shqetësuar për gjendjen e demokracisë së Shqipërisë. Sipas tij, çdo zgjedhje të ardhshme duhet të jenë të lira dhe të drejta dhe se blerja e votave është e papranueshme. Presidenti i PPE-së nënvizon se të drejtat e opozitës duhet të respektohen në parlament. "Nevojiten më shumë përpjekje për të luftuar krimin dhe korruptionin, përfshirë zbatimin e ligjit të dekriminalizimit", shprehet z.Daul. Mesazhi i presidentit të PPE-së vjen para protestës së thirrur nga opozita, e cila do të mbahet të shtunën, në orën 11:00.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

FOR CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RESCUE AND FIRE FIGHTING STATION (RFFS) BUILDING TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for construction of New Rescue and Fire Fighting Station (RFFS) Building.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist in general terms of: securing of the site, preparatory works, soil removal and excavations, drainage works, structural works, interior and exterior finish works, mechanical and electrical systems, external infrastructure including surrounding related pavement works, demolition of existing building and construction of the sport facilities.

To participate in this process interested parties shall submit officially in written form the expression of interest by letter at TIA premises. After receipt of the expression of interest until deadline 15 of February 2019, TIA will provide via email the Invitation to Tender and Confidentiality Commitment Document together with the respective forms. These documents and forms must be submitted filled and signed accordingly to TIA, Administration Building, Rinas, until 18 of February 2019.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms, prequalified based to specified qualifying criteria, will be given the respective set of Instruction to Tenderers with tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge to the prequalified companies, in a CD, on 20 of February 2019.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RFFS BUILDING" The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 18 March 2019**. Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvjika@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

SHPF in Albania is looking for a dynamic Executive Director with 5 years of relevant work experience. Under the overall supervision of Board of Directors and the President of the Association, the Executive Director is responsible for the day-to-day management of the SHPF activities, services, including all substantive and administrative matters. The position will be based in Tirana and be offered a full time assignment.

Duties & Responsibilities

- Manage and coordinate day-to-day SHPF activities, from substantive, administrative and financial points of view
- Ensure a good relationship with the SHPF Board members by supporting their operations. Responsible for implementing Board's strategic agenda and policies. Organize and facilitate regular Board of Directors' meetings
- Actively maintain existing members and seek out new members
- Ensure timely preparation and compilation of the SHPF Annual/Quarterly Work Plans and their submission to the Board as appropriate
- Prepare monthly reports for the Board on the SHPF key activities, issues and required action points. Prepare annual/semi-annual progress and financial reports and submit them to SHPF Board as appropriate. Ensures Committee's output is delivered according to organization's policies.
- Provide direction and leadership in advocating the SHPF objectives, in ensuring that all interested parties are well informed about the SHPF activities and goals
- Represent SHPF as required in Albania and build professional relationships with national and regional health care authorities and relevant national and international partners to ensure the full participation of a broad spectrum of national leadership in the identification, planning and execution of SHPF activities
- Serve as media contact in order to enhance SHPF image
- Advocate the interests of the members in improving the pharmaceutical business climate in Albania
- Maintain relationships with the Government of Albania and EFPIA

Required Qualifications/Competencies

- 5 years of relevant working experience.
- A Minimum of University Degree
- Strong managerial skills, ability to work in a dynamic and multipurpose environment.
- Highly developed leadership skills including the ability to inspire, encourage and build trust and confidence. Proven experience working in service to a broad range of clients and stakeholders
- In depth knowledge of the pharmaceutical market and dynamics. Solid understanding of the issues facing countries in economic transition
- Excellent communication skills both written and oral in both English and Albanian (conversant). Proven ability to draft, edit and produce written proposals and results-focused reports
- Proven experience working with Government, civil society, international organizations and donors
- Experience in the usage of computers and office software packages (MS Word, Excel, etc.)
- Familiarity with social media
- Strong and documented management skills and experience. He/she should be able to set clear standards for accountability, probity, value for money and risk management; to ensure sound and transparent financial management; and deliver continuing improvement in the SHPF effectiveness and in its systems to measure and report on this
- The ability to think beyond traditional modes and to be innovative in seeking solutions to complex operational and logistical challenges
- Ability to fulfill SHPF responsibility of accountability and transparency to members of the Board and other stakeholders
- Strong advocacy skills to be utilized in extensive public speaking, media interviews and interaction, giving testimony to intergovernmental bodies, and advocating for SHPF

The application deadline for this position is 27 February 2019

Please submit a CV and a cover letter, stating your motivation for applying and why you believe you are qualified for the position, to info.shpf@gmail.com

Only successful candidates will be contacted.

Në listë mungojnë emërimet për 16 shërbime të tjera

Zgjidhen 32 shefa të rinj në QSUT/ Zhgënjehen mjekët, bëjnë gati paditë

Ministret Manastirliu dhe Besa Shahini kanë firmosur dje miratimin e shefave të rinj të shërbimit në QSUT. 'BalkanWeb' ka siguruar listën me emrat e 32 shefave të rinj të shërbimit. Përzgjedhja e shefave të shërbime krijoi debat e pakënaqësi edhe në radhët e mjekëve në QSUT, sipas të cilëve në vend të transparencës së premtuar në nisje të garës, i gjithë procesi u zhvillua në mënyrën më hermetike të mundshme, mes tyre vijon të përfillet se përzgjedhja nuk është bazuar në konkurs, por ka qenë thjesht emërim. Dokumenti i shpërndarë në rrugë elektronike nuk ka asnjë firmë apo vulë të asnjë prej ministrive

SHEFAT E SHËRBIMEVE

Përzgjedhja e shefave të shërbime krijoi debat e pakënaqësi edhe në radhët e mjekëve në QSUT, sipas të cilëve në vend të transparencës së premtuar në nisje të garës, i gjithë procesi u zhvillua në mënyrën më hermetike të mundshme, mes tyre vijon të përfillet se përzgjedhja nuk është bazuar në konkurs, por ka qenë thjesht emërim.

përgjegjëse të Shëndetësisë dhe Arsimit dhe as emrat e dy titullarëve që kanë marrë vendimin. Ajo cka vihet re është fakti që në listë janë vetëm 32 shërbime nga 48 që ka QSUT. Ministria e Shëndetësisë sqaron se një numër çështjesh janë dërguar në gjykatë ndërsa në shumë

shërbime ka patur mungesë të kandidatëve të kualifikuar sipas ligjit në fuqi, ç'ka nënkupton një proces të dytë përzgjedhje. Burime për "News 24" thonë se janë 4 procese të hapura në gjykatat administrative për parregullsi serioze para dhe gjatë procesit si dhe në ven-

dimmarrjen e QSUT. Të njëjtat burime konfirmuan se nga dita e sotme do të ketë padi të reja në gjykatë pasi shumë prej mjekëve të zhgënjyer nga procesi ishin në pritje të dokumentit zyrtar. Ankesat kryesisht lidhen me parregullsi në dokumentacion, si dhe shkelje të ligjit të arsimit të lartë për kriteret e kandidatëve garues si dhe emërimet në kushtet e konfliktit të interesit. Si shembull, rektori i universitetit të Mjekësisë, z.Arben Gjata është zgjedhur njëherazi edhe në postin e Shefit të Shërbimit të Kirurgjisë, e po kështu edhe zv. dekan i Mjekësisë, z. Durim Çela

- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Kirurgjisë së përgjithshme I në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Z. Elmout Celiku
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Urgjencës dhe Pediatrisë së Përgjithshme në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Znj. Numila Kureshka
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Pediatrisë Infektive në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Znj. Gjorgjina Lito Kule
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Imazherisë dhe Mjekësisë Nukleare në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Z. Durim Çela
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Anestezi Reanimacionit në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Z. Ilir Othri
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Pediatrisë Specialiteti I në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Znj. Luljeta Kule-Shtjari
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Neurologjisë në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Znj. Jera Kruja
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Hipertensionit dhe Mjekësisë Interne në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Z. Mihal Tase
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Reanimacionit të Pediatrisë në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Znj. Elmira Kola
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Kardilogjisë I në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Z. Artan Goda
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Laboratorit Immunologjik në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Z. Gene Sulçebe
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Laboratorit Klinik Biokimik në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Znj. Anyla Balo
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Dijsjës Plastike në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Z. Durim Çela
- Emërimin e drejtuesit të shërbimit të Laboratorit të Gjenetikës në Qendrën Spitalore universitare "Nënë Tereza" Z. Durim Çela

Faksimile e dokumentit të shefave fitues në QSUT

njëherazi shef katedre në universitet është përzgjedhur çuditërisht edhe në postin e shefit të Shërbimit të Imazherisë dhe Mjekësisë nukleare një shërbim kyç që më së pari përballon me imazheri urgjen-

cat mjekësore. Po a mundet që shefi i shërbimit të jetë njëherazi në dy vende dhe në dy poste të ndryshme një pyetje që duhet t'i përgjigjet herët ose vonë titullarët e spitalit "Nënë Tereza". /E.S

"Kujdes, kontrolloni 'email'-in! Do t'u vijnë informacione të rëndësishme mbi procedurën"

Voltiza Duro

Lotaria Amerikane, ambasada: Çfarë duhet të dinë fituesit e DV 2019-ës

"Udhëzimet dhe dokumentacioni që duhet të dorëzoni"

Të gjithë ata shtetas shqiptarë që janë përzgjedhur si fitues të Lotarisë Amerikane 2019-të, duhet të bëjnë kujdes dhe të kontrollojnë 'email'-in, pasi mund të marrin informacione të rëndësishme lidhur me procedurën në vazhdim. Njoftimi është bërë ditën e djeshme nga ambasada amerikane në Tiranë, e cila thekson se sapo Çështja të jetë gati për shqyrtim, fituesit do të marrin 'email' nga KCC. "Të përzgjedhur të Lotarisë DV2019: ju duhet të keni qasje në 'email'-in juaj, pasi KCC do t'ju dërgojë informacion të rëndësishëm me 'email', sapo çështja juaj të jetë gati për shqyrtim", thekson ambasada. Pasi KCC merr dhe përpunon formularin e aplikimit DS-260 për aplikantin dhe anëtarët e familjes shoqëruese, do të merren udhëzime se si të skanohen dhe ngarkohen dokumentet mbështetëse të nevojshme. Intervista nuk do të caktohet derisa të dorëzohen kopjet e skanuara të të gjitha dokumenteve të kërkuara, duke ndjekur udhëzimet. Fituesi duhet të sjellë dokumentet origjinale në intervistën me zyrtarin konsullor. Rekomandohet që të fillojë këtë proces në fillim. Aplikanti dhe secili anëtar i familjes që do ta shoqërojë atë në Shtetet e Bashkuara do të duhet të dorëzojë kopjet e skanuara dhe çdo përkthim të kërkuar të dokumenteve origjinale ose kopjeve të vërtetuara të dokumenteve të listuara nga një zyre, autoritet ose subjekt lëshues i duhur në vendin e origjinës.

'EMAIL'-I NGA KCC

"Ju do t'ju kërkohet të sillni dokumentet origjinale në intervistën tuaj për vizë në ambasaden apo konsullatën e SHBA, së bashku me përkthimet e kërkuara. KCC do të dërgojë instruksione që shpie-



gojnë se si të skanoni dhe dërgoni 'email' dokumentet dhe përkthimet e kërkuara pasi të keni dorëzuar një aplikim të vlefshëm DS-260 për ju dhe për të gjithë anëtarët e tjerë të familjes. Vizita juaj e intervistës për vizë nuk do të caktohet derisa KCC të ketë pranuar dhe rishikuar të gjitha dokumentet e nevojshme mbështetëse. Ju do të merrni dokumentet origjinale me vete në intervistën tuaj në një ambasadë ose konsullatë të SHBA. Mos dërgoni asnjë nga këto dokumente në Qendrën Konsullore Kentucky pasi do të shkatërrohen", - bën me dije departamenti amerikan i shtetit. Ndërkohë, dokumentet civile dhe perso-

nale mund të ndryshojnë nga vendi në vend, varësisht nga disponueshmëria. Mund të ketë udhëzime shtesë për marrjen e dokumenteve civile në një vend të caktuar ose dokumente shtesë të kërkuara, varësisht nga Ambasada e SHBA-ve ose Konsullata ku do të aplikohet. Fituesit duhet të zgjedhin ambasadën ose konsullatën ku do të aplikojnë për të mësuar se cilat kërkesa shtesë ekzistojnë, nëse ka.

INTERVISTA

"Ju duhet të përgatiteni për intervistën tuaj me kujdes. Pamundësia për t'u përgatitur plotësisht për intervistën tuaj në ambasadën ose konsullatën e SHBA

mund të rezultojë në vonesë ose mohim të aplikimit për vizë. Pasi të keni njoftuar për intervistën tuaj të intervistës, do t'ju duhet të ndërmerri hapat e rëndësishëm përpara datës së intervistës", - bën me dije Departamenti Amerikan i Shtetit. Fillimisht duhet të shqyrtohet me kujdes informacioni i caktimit në Kontrollin e Statusit të Regjistrimit në faqen e internetit të E-DV, duke shënuar datën, kohën dhe vendndodhjen e intervistës për vizën e emigrantëve. Më tej duhet të merren në shqyrtim Udhëzimet e Intervistës së Ambasadës së SHBA-ve ose Konsullatës.

UDHËZIMET DHE DOKUMENTACIONI

- Fillimisht duhet të shqyrtohet me kujdes informacioni i caktimit në Kontrollin e Statusit të Regjistrimit në faqen e internetit të E-DV, duke shënuar datën, kohën dhe vendndodhjen e intervistës për vizën e emigrantëve.
- Më tej duhet të merren në shqyrtim Udhëzimet e Intervistës së Ambasadës së SHBA-së ose Konsullatës.
- Mund të jepen udhëzime shtesë nga Ambasada ose Konsullata e SHBA, ku do të aplikoni dhe intervistoni, prandaj ju lutemi t'i rishikoni me kujdes këto udhëzime.
- Programoni dhe përfundoni një provim mjekësor
- Ju (dhe çdo anëtar i familjes që aplikoni për vizë me ju) ju kërkohet të planifikoni një takim mjekësor me një mjek të autorizuar në vendin ku do të intervistoheni.
- Shpjegoni se ekzaminimi është për një aplikim për vizë emigrimi dhe jepni mjekun datën e intervistës. Mjeku do t'ju tregojë koston e ekzaminimit dhe testeve.
- Ju lutem vini re se disa nga informacionet e përfshira në këto udhëzime mund të zbatohen për klasifikimin e vizave të emigrantëve përveç vizave të diversitetit.
- Mblidhni fotot dhe të gjitha dokumentet e kërkuara
- Çdo aplikant i DV do të duhet të sjellë dy (2) fotografi identike në intervistë. Shqyrtto informacionin e detajuar rreth kërkesave të fotografive për të siguruar që fotot tuaja do të jenë të pranueshme.
- Dokumentacioni**
- Informacioni i takimit të printuar nga Kontrolli i Statusit të Regjistrimit në faqen elektronike të E-DV.
- Faqja e konfirmimit DS-260
- Pasaportë të vlefshme për gjashtë muaj pas datës së parashikuar për hyrje në SHBA për ju dhe çdo anëtar i familjes që aplikon për vizë.
- Dokumentet origjinale ose kopjet e vërtetuara të dokumenteve civile të dorëzuara në KCC.
- Sillni një fotokopje të ndonjë dokumenti që nuk i keni dorëzuar KCC-së si pjesë e procesit të kualifikimit të intervistës.



Jaeld Çela

Ankimoj zgjatjen e afateve të hetimit, gjykata rrezon kërkesën e ish-shefit të policisë, Jaeld Çela

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda ka hedhur poshtë kërkesën e ish-shefit të Policisë së Vlorës, Jaeld Çela, i dyshuar si garantor i grupit të "Habilajve" në trafikun e drogës për mbylljen e hetimeve. Ish-drejtori i policisë së Vlorës ankimoj zgjatjen e fundit të prokurorisë, afati i të cilit përfundon më 18 shkurt, ndërsa prokuroria pritet që

për Çelën të kërkojë një zgjatje tjetër të hetimeve. Pak ditë më parë gjykata vendosi të pranojë ankimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri për zgjatje të afateve, duke caktuar 10 marsin si afatin e fundit për të çuar dosjen me gjykatë, apo për pushimin e hetimeve. Jaeld Çela vijon të jetë në arrati prej më shumë se një viti. Ish-zyrtari i policisë është

shpallur në kërkim bazuar në një masë sigurie "arrest në burg" në mungesë në nëntor 2017. Sipas hetimeve, ish-drejtori i Policisë ka mbajtur në përdorim 3 numra telefoni, në të cilat rezultojnë se ka komunikuar me Florian Habilajn dhe Gentian Cekën, që është shoferi i ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Kjo nuk është hera e parë që

Çela ankohet për zgjatjen e afatit të hetimit. Ai bëri të njëjtën kërkesë nga arratia në mars të vitit të kaluar, kur hasi në refuzimin e gjykatës. Emrat e zyrtarëve që dyshohen si të përfshirë në dosjen "Habilaj" për trafikun e kanabisit janë ish-drejtori i Policisë së Vlorës, Jaeld Çela; Gjergj Kohila, shefi i sektorit të luftës kundër kriminit të organizuar, në drejtorinë e Qarkut Vlorë si dhe ish-drejtori i Postës së Dhërmit, Sokol Bode, të cilët më pas u arratisën jashtë vendit.

Reagon vëllai i 53-vjeçarit: Është i pafajshëm, 300 burra jemi mbyllur brenda nga turpi

SHKODËR

Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër ka shpallur moskompetencën për çështjen e inspektorit të Gruemirës, Berhan Bajrakurtaj, i cili dyshohet për ngacimin seksual ndaj një të miture. Çështja në ngarkim të 53-vjeçarit i është kaluar gjykatës për të mitur, duke qenë se denoncimi lidhet me të mitur. Në seancën e djeshme gjyqësore që u zhvillua me dyer të mbyllura, inspektor i Policimit në Komunitet, Bajrakurtaj është mbrojtur nga avokati i tij, Xhelal Bajraktari, i cili ka mohuar akuzat dhe ka kërkuar lirimin. Nga ana tjetër, prokurori i çështjes, Vat Staka ka kërkuar masën e sigurisë "Arrest me burg" me afat 30 ditë, deri në kryerjen e aktespërtimit të telefonit të efektivit të policit, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata. Mësohet se vetë Berhan Bajrakurtaj ka mohuar në gjyq se ka ngacmuar një të mitur. Ai ka thënë se celularin e ka pasur në servis dhe se nuk di ta përdor mirë. "Nuk kam ngacmuar asnjë të mitur. Kam qenë në shtëpinë time. Nuk e di se si ka dalë video. Para pak kohësh e kam çuar celularin në servis dhe më pas e kam pasur me kod. Unë nuk di ta përdor mirë celularin. Nuk kam ngacmuar asnjë person dhe s'e kam idenë si është shpërndarë video", ka thënë polici. Avokati i të pandehurit, Xhelal Kraja kërkoj të cilësohet ndalimi i paligjshëm dhe lirimin për shkak se sipas tij s'ka veprë penale. Ndërkohë, ka reaguar për mediat vëllai i efektivit të policisë, Afrim Bajrakurtaj. Ky i fundit mohoi se vëllai i tij kishte ngacmuar një të mitur, ndërsa u shpreh se çdo gjë është e stisur dhe e montuar. Afrim Bajrakurtaj akuzoi mediat për manipulim dhe tha se kjo është bërë për ta dëmtuar.

Videoskandali, polici Bajrakurtaj mohon akuzat në gjyq: Nuk di ta përdor celularin

Lihet 30 ditë në burg inspektor i Gruemirës, Gjykata e Shkodrës shpall moskompetencën për çështjen



Efektivi i policisë, Berhan Bajrakurtaj



Vëllai i policit, Afrim Bajrakurtaj duke folur për GSH-në

HETIMET
Zyrtarë të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat nga Tirana kanë marrë në pyetje efektivin Bajrakurtaj, i cili ka mohuar t'i ketë dërguar video me përmbajtje seksuale vajzës së mitur. Por pavarësisht këtij pretendimi, Policia e Shtetit dhe prokuroria e Shkodrës kanë nisur hetimet. Efektivi i Policisë së Malësisë së Madhe, Berhan Bajrakurtaj rezultojnë të jetë përjashtuar nga policia në vitin 2008. Gjatë kësaj kohe, ai ka punuar si faktorino në autobusin e linjës Shkodër-Koplik.

ARRESTIMI PAS SKANDALIT

Policia e Shkodrës arrestoi pak ditë më parë efektivin Berhan Bajrakurtaj, pasi dyshohet se ka ngacmuar seksualisht një vajzë 15-vjeçare. Specialisti i policimit në komunitet në zonën Grumirë të Malësisë së Madhe, Bajrakurtaj, u denoncua nga nëna e 15-vjeçares, e cila ka thënë se shefi i policisë e ka marrë në makinë vajzën dhe ka kryer akte të turpshme. Gjithashtu, ai e ka telefonuar vajzën dhe ka kryer biseda erotike përmes telefonit. Në media u publikua një video, ku polici shfaqej i zhveshur duke komunikuar me videokamera me 15-vjeçaren. Inspektor Bajrakurtaj është i martuar dhe baba i 4 fëmijëve, tri vajzave dhe një djali.

AKUZAT E VËLLAIT TË POLICIT

Ditën e djeshme reagoi për mediat vëllai i efektivit të policisë, Afrim Bajrakurtaj. Ai mohoi se vëllai i tij kishte ngacmuar një të mitur, ndërsa u shpreh se çdo gjë është e stisur dhe e montuar. Afrim Bajrakurtaj akuzoi mediat për manipulim dhe tha se kjo është bërë për ta dëmtuar. "Me të miturën nuk ka punë, në pastë punë ai, nuk është vëllai ynë. Nuk është vëllai ynë po pat punë me të mitur. Por nuk ka, ato janë rrena të tana, skenarë tuajtë, të mediave. Videoja është e bërë, e manipuluar nga mediat, nga ju. Ta hiqni videon se keni përgjegjësi. U njefsha të mirën!", deklaroi vëllai i inspektorit të policisë.

Çfarë ka ndodhur me vëllain tuaj?
Me të miturën nuk ka punë, në pastë punë ai, nuk është vëllai ynë. Nuk është vëllai ynë po pat punë me të mitur. Por nuk ka, ato janë rrena të tana, skenarë tuajtë, të mediave.
Pra, ju mendoni se videoja është e stisur?
Videoja është e bërë, e manipuluar nga mediat, nga ju.
Kush mendoni se e ka bërë atë video?
Ndonjë dashamirës si puna juaj, si ju, se nuk keni drejtësi kurrkund. Si arrestohet njeriu pa fakte, pa prova, pa kurrëgj. Ju sheh Zoti të tanëve.
Gjithçka është e qëllim-

shme sipas jush?
Është e çuditshme, ne na ka rënë bombë. Ne s'kemi dalë jashtë, tash tri ditë. Jena 300 meshkuj që na vjen marre me dalë dhe në rrugë të madhe.
Mund ta kenë bërë me qëllim për ta dëmtuar?
E kanë bërë me qëllim për ta dëmtuar, nuk e dimë se si u bë. Ne nuk i kemi gjë kujt borxh. Unë dal hapur, nëse vëllai ynë e ka bërë prapë atë punë mos e nxjerrtë kryet, s'na duhet ne gjë më. Por nuk e ka bërë, është manipulim mediash. Ta hiqni videon se keni përgjegjësi. U njefsha të mirën!

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda është në pamundësi të çelë procesin gjyqësor ndaj Suel Çelës dhe dy të akuzuarve të tjerë, për sulmin ndaj policisë në hyrje të tregut agroushqimor në Elbasan, për shkak se biznesmeni i shumëkërkuar nuk ka marrë njoftim. Në këto kushte, trupa gjyqësore urdhëroi kryer-

Procesi për Suel Çelën në ngërc, gjykata kërkon ndihmën e Interpolit

jen e kërkimeve të thellura për të pandehurin, ndaj të cilit rëndon akuzat e "vrasjes së punonjësit të Policisë së Shtetit" mbetur në tentativë dhe kryer në bashkëpunim. Në seancën e së enjtes, gjykata deklaroi se do të kërkojë ndihmën e Interpolit për kërkimet, kjo për faktin se Petrit Çela, babai i të pandehurit ka deklaruar se i biri është larguar jashtë vendit. Në proces mungojnë gjithashtu edhe dy oficerët e policisë, të cilët janë të dëmtuar nga vepra penale. Suel Çela akuzohet nga prokuroria si personi, i cili me makinën e tij tip "Audi" goditi në shtator të 2017 në hyrje të tregut agroushqimor, makinën e policisë, duke vënë në rrezik jetën e zëvendës-drejtorit të qarkut, Gjergj Oshafi dhe disa oficerëve të tjerë. Nën akuzë për këtë ngjarje janë vënë edhe dy miqtë e tij, Enea Bektishi dhe Kelmend Xhaferri.

VRASJET E GRAVE

INTERVISTA

Sociologu dhe "Mjeshtri i Madh": Instrumentet që mund të sjellin zbutje të situatës

Gëzim Tushi: Shoqëria shqiptare nuk do të pranojë që femra është njeri

"Mentaliteti patriarkal i meshkujve, shkaku kryesor i vrasjeve të grave"

Voltiza Duro

Shoqëria shqiptare ende nuk do të pranojë që femra është njeri! Meshkujt në vendin tonë kërkojnë ende atë femrën e dikurshme, që ishte brenda shtëpisë e vërtitej mes lavamanit, kuzhinës e fëmijëve. Ata kanë mbetur te biologjia e tyre: forca fizike dhe dhuna seksuale e me këto dy instrumente mendojnë të mbajnë të disiplinuar femrën për ta kontrolluar atë". Kështu është shprehur Gëzim Tushi, sociolog i njohur shqiptar dhe "Mjeshtri i Madh" gjatë një interviste për "Gazeta Shqiptare", lidhur me vrasjet e 7 grave dhe vajzave brenda 45 ditësh. Ai thekson se shkaku kryesor i agresivitetit të meshkujve ndaj femrave është mentaliteti i vjetër patriarkal, maskilist, historikisht i trashëguar nga shoqëria jonë, i cili nuk ka pasur respektin e duhur për femrën, goftë si grua, si nënë, si e bashkëshorte. Sipas Tushit, në ato familje ku femra është e papunë, mashkulli kërkon një status të privilegjuar për shkak se i siguron bukën e gojës gruas së tij. Sociologu bën me dije se shoqëria shqiptare është përbalë një nevojë për një revolucion të vërtetë në lidhjet me meshkujve dhe femrave dhe jep disa opsione për zbutjen e situatës.

Sot (dje) një tjetër grua është gjendur e vrasur, ndërkohë që për 45 ditë plot 7 femra kanë humbur jetën pas agresionit nga bashkëshortët, baballarët apo të dashurit e tyre. Cili është mendimi juaj si sociolog lidhur me këtë situatë?

Unë mendoj se ngjarjet e kohëve të fundit, vrasja në "seri" e femrave shqiptare për shkaqe nga më të ndryshmet është një situatë alarmante, anormale, që edhe metafora mjekësore e patologjisë është e pamjaftueshme për ta rrokur në dimensionin sasior dhe cilësor këtë patologji të përgjithshme të shoqërisë shqiptare. Për fat të keq, ditë



Sociologu dhe "Mjeshtri i Madh", Gëzim Tushi

pas dite, përballemi me raste të ndryshme të vrasjes së grave, pjesa më e madhe e krimeve të kryera nga bashkëshortët, të dashurit dhe njerëzit që kanë lidhje me to. Pjesa më e madhe e vrasjeve janë bërë për arsye banale, justifikime gesharake kriminale, duke filluar nga ato që kanë të bëjnë me të ashtuquajturën çështje nderi, e cila është bërë një "ombrellë" për të mbuluar sasinë e madhe të krimeve që kryejnë meshkujt në shoqërinë shqiptare. Ata shfaqen me një agresivitet të jashtëzakonshëm.

Pse gjithë ky agresivitet nga ana e meshkujve shqiptarë? Cilët janë faktorët që e kanë sjellë shoqërinë tonë në këtë pikë?

Shkaqet janë të shumta. Shkaku kryesor i agresivi-

tes pasur respektin e duhur për femrën, goftë si grua, si nënë, si e bashkëshorte; në të gjitha rolet që mund të jetë femra në shoqëri. Ky mentalitet patriarkal është ende shumë i fuqishëm dhe kjo është një arsye, e cila ndikon në këtë intensitet të krimeve, sepse meshkujt nuk e pranojnë marrëdhënien parteriale me femrën e tyre, por duan të jenë sundues, të vendosin kufirin, lirinë për gratë dhe të përcaktojnë se çfarë duhet të bëjë ajo, si të sillet, si të vishet e me kë duhet të shoqërohet. Në këtë mënyrë, martesat kthehet nga një marrëdhënie e lirë dhe funksionuese, në një burg për femrën, pra jo një marrëdhënie mes dy parterësh, por një marrëdhënie mes një padroni (mashkulli) dhe një

FAKTORI EKONOMIK

Në ato familje ku femra është e papunë, mashkulli kërkon një status të privilegjuar për shkak se i siguron bukën e gojës gruas së tij. Ky është mentaliteti i një "prostitucionit të maskuar", ku mashkulli kërkon nga femra e tij të gjitha favorët që dëshiron vetëm për faktin që ai e ushqen.

tetit të meshkujve ndaj femrave është një mentalitet i vjetër patriarkal, maskilist, historikisht i trashëguar nga shoqëria jonë, i cili nuk

skllaveje (femra). **A ndikon patriarkaliteti në këtë situatë dhe sa i theksuar është ai?** Një tjetër arsye e këtij

SITUATA

Unë mendoj se ngjarjet e kohëve të fundit, vrasja në "seri" e femrave shqiptare për shkaqe nga më të ndryshmet është një situatë alarmante, anormale, që edhe metafora mjekësore e patologjisë është e pamjaftueshme për ta rrokur në dimensionin sasior dhe cilësor këtë patologji të përgjithshme të shoqërisë shqiptare.

agresioni nga ana e meshkujve është përpalsja e korrozivitetit të vjetër morale për shikimin e femrës, të iniciativës, të së drejtave dhe lirisë së saj. Shoqëria shqiptare



Vendi ku u gjet trupi i pajetë i nënës së 4 fëmijëve

qiptarë, është i papranueshëm dhe kjo po sjell krime shumë të mëdha. Jemi në një shoqëri moderne dhe postmoderne, nuk mund të nxjerrim mekanizmat e ndryshkur të së kaluarës për të vendosur disiplinën për femrat. Gjithashtu, në shoqërinë shqiptare ka një përdorim të gjerë të lëndëve psikotropike, të alkoolit e drogave që po sjellin dëme të mëdha. Një pjesë e madhe e

në familje. Ata që kanë vrasur gratë, jo në pak raste kanë qenë burra të kthyer nga emigracioni dhe ndeshen me thashetheme dhe kur vijnë këtu i rikthehen mentalitetit lokalit dhe për shkak të dyshimeve i vrasin gratë se bëhen pre e paragjykimëve.

A nuk e perceptojnë dot si zgjidhje divorcin burrat shqiptarë, në vend që t'u marrin jetën grave të tyre?

Koncepti që po sjell krime të shumta është e ashtuquajtura "shkelje e nderit" nga ana e grave dhe kjo i jep të "drejtën" burrave të kryejnë një veprim që miratohet edhe nga një pjesë konservatore e shoqërisë, e cila thotë "mirë ia bëri".

OPINIONI PUBLIK

Koncepti që po sjell krime të shumta është e ashtuquajtura "shkelje e nderit" nga ana e grave dhe kjo i jep të "drejtën" burrave të kryejnë një veprim që miratohet edhe nga një pjesë konservatore e shoqërisë, e cila thotë "mirë ia bëri".

ende nuk do të pranojë që femra është njeri. Ajo hyn në martesë dhe ka disa detyrime, por nuk duhen harruar të drejtat që ajo ka. Ndërkohë, meshkujt në vendin tonë kërkojnë ende atë femrën e dikurshme që ishte brenda shtëpisë e vërtitej mes lavamanit, kuzhinës e fëmijëve. Femra sot është bërë më e shkathët, më iniciatore, ka më shumë vetëvlerësim e si gjini dëshiron të jetë e pavarur. Ajo e pranon rolin e saj si nënë e bashkëshorte, por jo sipas korrozivitetit të vjetër morale. Meshkujt kanë mbetur te biologjia e tyre: forca fizike dhe dhuna seksuale e me këto dy instrumente mendojnë të mbajnë të disiplinuar femrën për ta kontrolluar atë. Ky mentalitet skllavërues i meshkujve sh-

krimeve kanë qenë nën efektet e alkoolit.

Po faktori ekonomik sa ndikon në nënshkrimin e femrës nga ana e meshkujve?

Në ato familje ku femra është e papunë, mashkulli kërkon një status të privilegjuar për shkak se i siguron bukën e gojës gruas së tij. Ky është mentaliteti i një "prostitucionit të maskuar", ku mashkulli kërkon nga femra e tij të gjitha favorët që dëshiron vetëm për faktin që ai e ushqen. Kjo është një kambanë alarmi që ne duhet të shikojmë punësimin e grave, rritjen e autoritetit të tyre financiar në familje, në mënyrë që t'i shpëtojnë kësaj maske të "prostitucionit të maskuar". Edhe emigracioni është një faktor tjetër që ndikon në krimin

koncepti që po sjell krime të shumta është e ashtuquajtura "shkelje e nderit" nga ana e grave dhe kjo i jep të "drejtën" burrave të kryejnë një veprim që miratohet edhe nga një pjesë konservatore e shoqërisë, e cila thotë "mirë ia bëri". Kur burrat vrasin gratë për mungesë besnikërie bashkëshortore, na përball me një akt mesjetar, kjo është një zgjidhje kafshërore që buron nga mentaliteti që grua është pronë e tyre. Ka zgjidhje të qytetëruara. Divorci nuk është emancipim i martesës, por është një mjet që zgjidh konfliktin, goftë edhe për shkeljen e kurorës. T'i jepet një zgjidhje e kulturuar, nuk ka pse të zgjidhet një rrugë e përbindshme si vrasja. Shoqëria shqiptare mbarat një shkak madhor që ka krim të madh brenda familjes, sepse kultura e martesës dhe e divorcit është shumë e dobët. Pikërisht ngaqë martesën e bëjnë nga tundimet e seksualitetit dhe nuk e konsiderojnë më përgjegjësi, ajo kthehet në një vater konfliktualiteti, që kalon deri në krim. Madje, edhe divorci janë të dhunshme, pasi meshkujt nuk pranojnë të emancipohen e të progresojnë në



Krimi makabër, dyshohet se viktima kishte lidhje jashtëmartesore me 39-vjeçarin

Përgjaket Shën Valentini, vritet me 3 plumba në kokë dhe në trup nëna e 4 fëmijëve

49-vjeçarja Lirie Xhepa u gjet e pajetë mes shkurreve te Liqeni i Sharrës, policia shpall në kërkim kunatin

TIRANË

Përgjaket dita e Shën Valentinit. Një grua është gjetur dhe e masakruar në afërsi të Liqenit të Sharrës në Tiranë. Bëhet fjalë për 49-vjeçarën Lirie Xhepa, trupi i pajetë i së cilës u gjet nga banorët e Kodër Sharrës e hedhur mes shkurreve. Mësohet se në trupin e viktimës kishte shenja dhune, të cilat mendohen se mund të jenë bërë me mjete të forta si dhe tre plumba pistolette. Njërën e kishte marrë në kokë dhe dy të tjerët në qafë. Menjëherë pas sinjalizimit për gjetjen e gruas së vrarë, në vendngjarje kanë mbërritur efektivat e Komisarariatit nr 6, të cilët kanë nisur hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të këtij krimi makabër. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, burime nga policia bëjnë me dije se dyshohet për krim në familje dhe se ngjarja mund të ketë ndodhur për shkak të marrëdhënieve familjare. Po të njëjtat burime pohuan se dyshohet që autori i këtij krimi mund të jetë kunati i së ndërës, Dashamir Xhepa, i cili është shpallur në kërkim.



49-vjeçarja Lirie Xhepa me bashkëshortin e ndërës



Kunati i viktimës, Dashamir Xhepa, i shpallur në kërkim

VIKTIMA

Lirie Xhepa ishte nënë e 4 fëmijëve dhe banonte afër vendit ku u gjet e vrarë. Mësohet se dy prej fëmijëve të saj janë emigrantë jashtë vendit, ndërsa jetonte me njërin nga dy djemtë e saj që ndodhen në Shqipëri, pasi njëri prej tyre është prej disa vitesh në burg (pohohet të jetë dënuar për drogë). Ajo kishte mbetur e ve që prej 15 vitesh, ndërsa dyshohet se kishte lidhje intime me njërin nga kunetërit dhe konkretisht Dashamir Xhepën, që është shpallur zyrtarisht në kërkim policor.

← rrugën e qytetërimit human lidhur me femrat e tyre.

Si reagon opinioni publik lidhur me këto ngjarje?

Shoqëria shqiptare nuk është totale nga pikëpamja e niveli të zhvillimit kulturor, arsimor dhe qytetar. Në shoqërinë tonë ka një elitë intelektuale, një klasë të mesme që di të procedojë humanisht si dhe ka një shtresë të prapambetur, një të paarsimuar, një të marxhualizuar. Pra, në këtë strukturë të ndërlikuar të shoqërisë shqiptare, reagimet e opinionit publik ndaj akteve të tilla janë të ndryshme. Për fat të keq, shoqëria shqiptare në mazorancë ka mentalitetin konservator, sipas të cilit femra që kryen një shkelje të besnikërisë bashkëshortore apo një lidhje paralele, duhet të ndëshkohet radikalisht. Opinioni i konservatorëve nënkupton që është e drejtë e maskullit, që për shkak të tradhtisë t'i marrë jetën gruas. Ky është një koncept edhe më primitiv.

Cilat janë disa nga zgjidhjet që ju sugjeroni për të zbutur situatën?

Jemi përballë një nevojë për një revolucion të vërtetë në lidhje me meshkujve dhe femrave në shoqërinë tonë. Zgjidhjet për të zbutur situatën janë të shumta. Ne kemi nevojë të përqendrohemi te gjithë faktorët socialë, që kanë ndikime kulturore dhe edukative. Në shoqërinë liberale, nuk është shteti, as ligji që e zgjidhin këtë problem. Këta të fundit normalisht që kanë rolin e tyre, por krimet po ndodhin brenda në familje dhe familja është një institucion i jetës private ku

VRASJET E GRAVE DHE VAJZAVE NË 45 DITË

- Më 2 janar 2019, një vrasje dyfishë tronditi Ballshin. 34-vjeçari Gazmet Mustaj masakroi me 28 goditje me thikë bashkëshorten 31-vjeçare, Gentiana Çauhaj dhe kunatën 18 vjeçe, Merisa Çauhaj. Krimi makabër ndodhi në sy të 2 fëmijëve të mitur të çiftit.
- Më 3 janar 2019 u bë publike një tjetër vrasje makabre që ndodhi në Alepu, Korfuz të Greqisë, ku shqiptari Aleko Petro masakroi vrau vajzën e tij 28-vjeçare, Anxhelina Petron dhe më pas e fshehu trupin e saj në kopshtin e shtëpisë.
- Më 14 janar 2019, Majlind Lila, 52 vjeç, ekzekutoi në Tiranë vjehrin dhe vjehërin, të ndërjerët Bujar dhe Xhevahirë Mata duke i lënë ata të vdekur në vend.
- Më 6 shkurt 2019, Teodor Lera, 57 vjeç nga Vloca mbyti me duar në fytyrë bashkëshorten 45-vjeçare, Eva Lera, (nënë e tre fëmijëve) dhe tentoi të vetëvrite duke prerë damarët.
- Më 12 shkurt 2019, efektivi i Gardës së Republikës, Alket Arapaj, vrau bashkëshorten 36-vjeçare, Ervilma Seferaj, nënë e një vaje 3 vjeçe.
- Më 14 shkurt 2019, gjendet e vrarë me 3 plumba në kokë dhe në trup, 49-vjeçarja Lirie Xhepa, nënë e katër fëmijëve. Dyshohet se autori i vrasjes është kunati, 39-vjeçari Dashamir Xhepa.

tuar në kodrat e Liqenit të Sharrës për të humbur gjurmët. Kjo për faktin se disa nga banorët raportuan se kishin parë në mëngjes herët një automat të bardhë që ishte afruar dhe kishte qëndruar pak minuta. Ndërsa një nga fqinjët shumë pranë vendit ku u gjet trupi deklaroi se s'kishte dëgjuar asnjë të shtënë, ndërsa Lirien e njëjti si banore e

lagjes. Njoftimi në polici nga banorët ka ardhur rreth orës 08:18 kur është konstatuar trupi i pajetë. "Policia po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe vlerën që ka autorit", pohuan burimet policore. Sipas bluve, gruaja është qëlluar për vdekje me katër plumba pistolette. Të afërmit të viktimës u shprehën se Liria

ishte nënë e katër fëmijëve dhe se banonte shumë pranë zonës ku u gjet e pajetë. Bashkëshorti i të ndërës ishte ndarë nga jeta 15 vite më parë dhe ajo jetonte me dy prej fëmijëve. "Ishte grua e sjellsme dhe e mirë. Unë i kam njerëzit e mi ata... I ka vdekur burri para disa vitesh dhe ishte grua e lartë. Punonte tek çanta në Kombinat",

tha njëri nga të afërmit. Nga ana tjetër, burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se viktima prej kohësh ka pasur mosmarrëveshje me vëllezërit e bashkëshortit, që dyshonin për një lidhje dashurie të 49-vjeçares. Sipas këtyre burimeve nuk përjashtohet mundësia e një lidhje jashtëmartesore të Dashamir Xhepës me kunatën e ve. Gjetja e trupit të së ndërës pranë banesës së njërit prej kunetërve ka krijuar dyshimet tek hetuesit se ky është një krim për shkak të marrëdhënieve familjare dhe pas pranisë së prokurorit Olsi Dado në vendngjarje kjo dosje do t'i referohet Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Shoqëria shqiptare prej kohësh përpillet në një tranzicion të tejzgjatur jo vetëm politik e ekonomik, por sidomos në një tranzicion moral e konceptual që ka të bëjë me ndryshimin e parimeve, të normave të sjelljes. Normat qytetëruese të ne po vijjnë shumë ngadalë. Pikërisht mungesa e instrumenteve qytetëruese, e dialogut, zgjidhjes së konflikteve në mënyrë njerëzore. Nëse funksionojnë instrumentet e sipërpërmendura, do të krijohet një strukturë kompakte ku secili nga këta faktorë të luajë rolin e vet dhe ka mundësi të përshpejtojnë procesin e qytetërimit të shoqërisë sonë.

Shitje me Ankanë të dyle nga Studio Permbartimore L.D.C

"Trulli + ndertesë" me nr. pasurie 286/51, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale. 3866, me sipërfaqe totale 300 m2, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar per shitje eshte 2.175.096 Leke.

Data e shpalljes 22.01.2019
Data e zhvillimit 21.02.2019 deri ne oren 16.00
Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbartimore L.D.C me adrese Rruga "Mystyl Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Ndërtimet e paligjshme, miratohet fondi për pagesën e tokës së zënë pa leje

VKM-ja/ ALUIZNI, jep 552 mln lekë për kompensimin e 753 pronarëve

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë

Qeveria miraton kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi i vënë në dispozicion është rreth 552 milionë lekë. ALUIZNI publikon listën me 753 pronarë që përfitojnë fondin e miratuar dje. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në drejtoritë për ALUIZNI-t, përkatësisht në Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtetas, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Kavajë, Fshatra Turistikë dhe Kamëz, Vorë. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, vlera e kompensimit për 43 920,53 m² është 522 842 426,65 lekë.

VENDIMI

Në vendim përcaktohet se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI si rrjedhojë e kalimit të pronësisë ndërmjet shitjes së parcelës ndërtimore si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. Qeveria përcakton se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë ndërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. "Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatësisht, në Tiranë, Elbasan, Durrës, Vlorë, Korçë, Kukës, Kavajë

dhe Shkodër të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri, në regjistrat e pasurive të paluajtshme", përcakton më tej vendimi. Ndërkohë, ngarkohen Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe

Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

APLIKIMI

Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kër-

- APLIKIMI PËR TË MARRË PARATË DHE DOKUMENTET**
- 1. ATP-ja, në zbatim të VKM nr. 383/2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale" i ndryshuar, procedon si më poshtë:
 - 2. Njofton publikisht në media dhe/ose nëpërmjet faqes zyrtare, listën e personave që përfitojnë nga fondi i kompensimit të pronave, për periudhën përkatëse.
 - 3. Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së njoftimit publik.
 - 4. Subjekti apo përfaqësuesi me prokurë paraqet pranë ATP-së gjithë dokumentacionin e lartpërmendur.
 - 5. Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës.
 - 6. Grupi i punës, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen verifikimet e duhura.
 - 7. Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës: a) nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi; b) urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen; c) njofton kërkuesin që nuk përfshihet në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mos përfshirjes.

jekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së, Tiranë, kërkesën-tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimitarëve për të gjithë trashëgimitarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimitarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit, për dëshmitë e trashëgimitarëve të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt notarial të sille certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokurë nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

Numri i Pronarëve që kompensohen	Kompensimi i Pronarëve							
	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
313	GAZMEND	PETRIT	HASEKIU					
314	IBRAHIM	PETRIT	HASEKIU					
315	ILIR	SELIM	GRACENI					
316	JETA	FAIK	BASHA					
317	LUAN	SHEFOET	BAHOLLI					
318	MEHMET	SELIM	GRACENI					
319	NAZIF	SHEFOET	BAHOLLI					
320	SHKENDI	IBRAHIM	RUSI					
321	SKENDER	SHEFOET	BAHOLLI	47	1374/20	1.4	12,764	17,869.60
322	TEFTA	SHEFOET	RAFAL					
323	VIOLLCA	SELIM	PAPADHIMTRI					
324	ULIS	IBRAHIM	HASTOPALLI					
325	AGIM	OSMAN	KINA					
326	ERMIRA	HYSEN	KINA					
327	RAJNA	BASHKIM	KINA					
328	PLARENT	BASHKIM	KINA					
329	RUZHDI	OSMAN	KINA					
330	HATI	GANI	SHKALLA	48	1351/2	60	12,764	765,840.00
331	ERMIRA	IBRAHIM	DORACI					
332	KUJTIM	FAIK	DORACI					
333	LLJANA	IBRAHIM	DORACI(HUTA)					
334	TEUTA	IBRAHIM	DORACI(PAPAV ANQJELLI)					
335	SHEMSI	QAZIM	CURRI					
336	ELIZA	MEHMET	DORACI(KURTI)					
337	DALLENDY SHE	MEHMET	DORACI					
338	ARBËN	FAIK	KODRAXHIU	49	1362/2	144.5	12,764	1,844,398.00
339	MAHMUT		DORACI	50	1362/26	74.5	12,764	950,918.00

Numri i Pronarëve që kompensohen	Kompensimi i Pronarëve							
	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
340	MEHMET		PAJUNI	51	307/14	1232.5	12,764	15,731,630.00
341	MUSTAFA		BYLYKBASHI					
342	HYOMET		XHERRI					
343	LINDITA		QEVANI					
344	MERITA		KARAJ					
345	MATEO		XHERRI					
346	EMIN		XHERRI					
347	VALBONA		QEVANI	52	1415/8	291.10	12,764	3,715,600.40
348	ELIDA	MEHMET	HASEKIU					
349	FATMIR	HAKI	HASEOIU					
350	HYSEN	MEHMET	HASEKIU					
351	LUAN	HAKI	HASEOIU					
352	NIMETE	MEHMET	HASEKIU					
353	SHAHU	HAKI	HASEOIU					
354	MIMOZA	MEHMET	HASEKIU					
355	VALENTINA	ASHKI	HASEOIU					
356	OAZIM	ASHKI	HASEOIU					
357	VERONIKA	ASHKI	HASEOIU					
358	LEONORA	ASHKI	HASEOIU					
359	MERITA	ASHKI	HASEOIU					
360	ARTA	ASHKI	HASEOIU					
361	VJOLLCA	SHEFOET	HASEOIU					
362	KLEVIN	FERDINAND	HASEKIU					
363	ENE A	FERDINAND	HASEOIU	53	1320/30	203.5	12,764	2,597,474.00
364	RUZHDI		PEZA					
365	XHAFER	MUSTAFA	KARADAKU					
366	ZYHA		OSMANAJ					

Numri i Pronarëve që kompensohen	Kompensimi i Pronarëve							
	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
				54	205/1	2,580.40	12,764	32,936,225.60
367	ROBERT	RITVAN	GAJDA					
368	FATBARDH	SELMAN	LEKA					
369	SHPRESA	SHAQIR	BARDHI					
370	HILMI	HAMIT	SHINGJERGJI					
371	SHEMSI	RAKIP	MANJANI					
372	TEUTA	SHEMSI	MANJANI					
373	SOKOL	SHEMSI	MANJANI					
374	ILJAZ	SHAQIR	LLATJA					
375	EDLIRA	SHAQIR	LLATJA					
376	ERMIRA	SHAQIR	LLATJA					
377	BOIKEN	ARDIAN	LEKA					
378	FLORIANA	ARDIAN	LEKA					
379	TRITAN	MIRDASH	KALO					
380	LULZIM	MIRDASH	MOLLOHOLLI					
381	SPARTAK	XHAFERR	BAKLLAMAJA					
382	ISAVETA	QAMIL	LEQEJZA					
383	MIGEN	RITVAN	GAJDA					
384	ALFRED	QAMIL	MUZHAGI					
385	DASHAMR	QAMIL	ÇENGELI					
386	FLORIKA(G	KOSTANDI	MOLLOHOLLI					
387	JEBROS	ALI	MOLLOHOLLI					
388	LOLITA	ALI	BUSHATI					
389	NADIRE	BAJRAM	MOLLOHOLLI					
390	FATBARDH	ABDYL	LOLJA					
391	HYSEN	ABDYL	MOLLOHOLLI					
392	ESMERALD	ABDYL	MOLLOHOLLI	55	1413/4	273.60	12,764	3,492,230.40
393	AGRON	TEKI	TELA					
394	ANITA	MASAR	ALICKA					
395	BULENT	TEKI	TELA					
396	EDMOND	TEKI	TELA					
397	FELATUN	MAZLLEM	KARAIKAJ					
398	GJERAK	MAZLLEM	KARAIKAJ					
399	HAJALI	ISMAL	YPI					
400	LAVDIJE	SKENDER	KALASA					
401	NEBI	ISMAL	SEFA					
402	NEFUE	TEKI	SELENICA(TEL					
403	SHAZIVAR	MASAR	KARAOŞMANI					
404	SHEGUSH	MASAR	KOSOVA					
405	SUHELA	XHEVDET	LIBOHOVA					
406	TEUTA	SKENDER	FORA					
407	XHANETA	ISMAL	PRODANI					
408	NEFUE	TEKI	SELENICA(TEL	56	165/2	458.60	12,764	5,853,570.40
409	OMER	AZMI	STRINGA					
410	ARBEN	AGRON	STRINGA					
411	ERVIN	MUSTAFA	LAMÇJA					
412	GLADIOLA	AGRON	STRINGA(DAKLI					
413	LUMNJE	ZUA	LUNIKU(MUÇO)					
414	MERITA	MUSTAFA	LAMÇJA(DURO)					
415	PRANVERA	AZMI	HAMZAJ(STRIN					
416	VJOLLCA	ZUA	LUNIKU					
417	LILJANA	MUSTAFA	LAMÇJA(BIÇOK					
418	BENON	MUSTAFA	LAMÇJA					
419	BRIKENA	SEZAI	HAXHIADËMI(BA					
420	ALEMSHA	AZMI	BOLLANCI(STRIN	57	1376/36	264.40	12,764	3,374,801.60
421	IBRAHIM		BEVAPI	58	1376/13	56.50	12,764	721,166.00
422	AFERDITA	YMER	HASEQIU(HAXHI					
423	AGIM	YMER	HAXHIMUSAJ					
424	ANILA	MUSTAFA	KATRO(SHOPI)					
425	BURBUQE		STRUÇU					
426	FERDINAND		STRUÇU					
427	FLORINDA		FUGA(STRUÇU)					
428	HATIXHE	MUSTAFA	SHOPI(KARKANA					
429	HEDUE	YMER	HAXHIMUSAJ					
430	LUMTURI		FUGA(STRUÇU)					
431	MIMOZA	MUSTAFA	SHOPI(CEKA)					
432	MIRELA	MUSTAFA	SHOPI					
440	DORINA	BARDHUL	HASEQIU					
441	KRESHNIK	FRANK	UCAJ					
442	FLORA	XHAFERR	HASEKIU(UCI)					
443	FISNIK	XHAFERR	HASEKIU					
444	ENGJELL	XHAFERR	HASEKIU					
445	FEIME	SKENDER	HASEQIU					
446	MARSELA	BARDHUL	HASEQIU					
447	DORINA	BARDHUL	HASEQIU					
448	KRESHNIK	FRANK	UCAJ	61	1415/258	110.7	12,764	1,412,974.80
449	ABDULLA	DERVISH	BANJA					
450	BASHKIM	OSMAN	GJEVORI					
451	ENVER	SHEFKI	VRAPI					
452	FUAT	DERVISH	BANJA					
453	HEDUE	SHEFKI	GOGA(VRAPI)					
454	IKBAL	DERVISH	LISI(BANJA)					
455	ISMAL	DERVISH	BANJA					
456	ISUF	SHEFKI	VRAPI					
457	KUJTIM	SHEFKI	VRAPI					
458	LILJANA	SHEFKI	VRAPI					
459	LINDITA	HIOMET	SPAHIU					
460	NAZF	DERVISH	BANJA					
461	NDRICIM	OSMAN	GJEVORI					
462	PULLUMB	HIOMET	SPAHIU					
463	RIZA	HIOMET	SPAHIU					
464	SHEFIKAT	RIZA	ZHUPANI(SPAHIU					
465	SHPRESA	HIOMET	SHYPHEJA(SPAHI					
466	URIM	OSMAN	GJEVORI	62	1380/29	232.2	12,764	2,963,800.80
467	HAXHI		ASLLANI					
468	XHAFERR		HAXHIASLLANI	63	1380/30	114.9	12,764	1,466,583.60
469								
470	DELIMET	MEHMET	BANGA	64	303/1	836.40	12,764	10,675,809.60
471	GAZMEND	DEMIR	PALLOSHI					
472	REFIK	AHMET	PALLOSHI					
473	SHEFIKAT	AHMET	GARUNJA(PALL					
474	LIRI	AHMET	LABINOTI					
475	EMINE	AHMET	PALLOSHI					
476	AGIM	AHMET	PALLOSHI					
477	HAMDI	AHMET	PALLOSHI					
478	SHPETIM	AHMET	PALLOSHI					
479	FATIME	DEMIR	KARADAKU					
480	ALBANA	DEMIR	BALLICI					
481	GAZMEND	DEMIR	PALLOSHI	65	1415/267	48.60	12,764	612,672
482	REFIK	AHMET	PALLOSHI					
483	SHEFIKAT	AHMET	GARUNJA(PALL					
484	LIRI	AHMET	LABINOTI					
485	EMINE	AHMET	PALLOSHI					
486	AGIM	AHMET	PALLOSHI					
487	HAMDI	AHMET	PALLOSHI					
488	SHPETIM	AHMET	PALLOSHI					
489	FATIME	DEMIR	KARADAKU					
490	ALBANA	DEMIR	BALLICI	66	1415/268	771.80	12,764	9,851,255.20
491	HASAN		KILA	67	1380/11	737.10	12,764	9,408,344.40
492	ARTAN	QEMAL	DARDHA					
493	VIOLETA	QEMAL	KADA					
494	MIMOZA	AVNI	ÇABIRI					
495	ARIAN	AVNI	STAROVA	68	1380/16	488.2	12,764	6,231,384.80
496	NAFTALIA		DOKSANI					
497	ZANA	LLAZAR	STATHI					
498	LILJANA	LLAZAR	KELLIÇI					
499	VERON	HASAN	DUMA					
500	MELITA	HASAN	DUMA	69	132/14	1,490.90	12,764	19,029,847.60
501	LAZER	DHIMTER	PAPAJANI					
502	VENEMIN		JOSIFI					
503	ANILA		DEMIR(JOSIF					
504	ERNEST		NASTO					

12 - SPECIALE

E premte 15 Shkurt 2019

GAZETA SHQIPTARE

Numri i Pronareve e qe kompensohen	Kompensimi i Pronareve							
	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
505	AHMET	RAMAZAN	BYLYKBASHI	70	142/2	1513.2	12.764	19,314,484.80
506	AHMET	RAMAZAN	BYLYKBASHI	71	142/3	5.40	12.764	68,925.60
507	AHMET	RAMAZAN	BYLYKBASHI	72	142/5	101.50	12.764	1,295,546.00
508	KUJTIM	EMIN	BAKALLI	73	89/14	784.2	12.764	10,009,528.80
509	ZENEPE		SOJLI					
510	ELDA	ISUF	RABETA(BAKALLI)					
511	ARDIAN		CANI					
512	MUSTAFA	DILAVER	CANI					
513	BIHANE		BAKALLI					
514	ALEMSHA	EMIN	ÇERRAGA(BAKALLI)					
515	VJOLLCA	SEID	BAKALLI					
516	BUJAR	EMIN	BAKALLI					
517	SHEGUSH	YMER	BIÇOKU					
518	MIRANDA	YMER	TOSKU					
519	ARDIT	YMER	KUÇI					
520	SAMIR	YMER	BAKALLI					
521	DALIP	KADRI	BAKALLI					
522	EDUART	MUSA	DUHANXHI	74	1413/1	775.1	12.764	9,893,376.40
523	IRMA	HAJRULLA	MURATI					
524	MEHMET	HYSEN	SHUAKU					
525	MERDUJE	KAMBER	DUHANXHI	75	198/2	487.30	12.764	6,219,897.20
526	RAJMONDA	HYSEN	COMO					
527	SHEFQET	KAMBER	DUHANXHI					
528	SHPRESA	MUSA	DUHANXHI					
529	BURBUQE	HYSEN	XHEPA					
530	QAZIM	MUSA	DUHANXHI					
531	HYSEN	VELI	GJATA					
532	ISUF	KAMBER	GJATA					
533	ADEM		BAKALLI					
534	AISHE		BAKALLI					
535	ADEM		BAKALLI	76	196/1	9.2	12.764	117,428.80
536	AISHE		BAKALLI					
537	LINDITA	ASTRIT	SANXHAKTARI	77	273/5	223.70	12.764	2,855,306.80
538	ADELE		MIRAKU					
539	ARBEN	BARDHYL	MIRAKU					
540	ADNANT	BARDHYL	MIRAKU					
541	DANIELA	BARDHYL	MIRAKU					
542	SOKOL	ASTRIT	SANXHAKTARI					
543	MEVLUDE		MIRAKU					
544	FIQIRETE	SELIM	TABAKU					
545	GEZIM	KASEM	TABAKU					
546	SADIK	KASEM	TABAKU					
547	ZEGJINE	TAHIR	TABAKU					
548	ARBEN		TABAKU					
549	BALLKIZE		TABAKU					
550	BARDHYL		TABAKU					
551	ISMAIL		ELEZI					
552	ERVALDO		TABAKU					
553	HAMDI		TABAKU					
554	HATUJE		TABAKU	79	7/683	41.00	32,878	1,347,998.00
555	KUJTIM		TABAKU					
556	MIRANDA		TABAKU					
557	NEXHMUE		TABAKU					
558	RINO		TABAKU					
559	SANIJE		TABAKU					

Numri i Pronareve e qe kompensohen	Kompensimi i Pronareve							
	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
560	SKENDER		TABAKU	80	8/474	361.40	29,106	10,518,908.40
561	ZENEPE		TABAKU					
562	BAKUSHE	ABDULLA	BODINAKU	81	2/952	300.20	29,106	8,737,621.20
563	BEDRIE		BODINAKU					
564	HYRIJE	ABDULLA	DUKA					
565	NURIJE	ABDULLA	MEZINI					
566	QAMILE	ABDULLA	LAÇI					
567	SEMHA	ABDULLA	HUÇI					
568	SHYQYRI	ABDULLA	DERHEMI					
569	EOEREM	HAXHI	VATHI					
570	ERMIR	MEHMET	VATHI					
571	HATLJE	HAXHI	SHARRA					
572	HAXHI	MEHMET	VATHI					
573	NERIMAN	MEHMET	VATHI					
574	NEXHMUE	MEHMET	VATHI					
575	QAMILE	HAXHI	VATHI					
576	XHAVIT	HAXHI	VATHI					
577	ARTUR	SEFER	VATHI					
578	EDMOND	SEFER	VATHI					
579	FATMIRA	SEFER	SALKU					
580	HAMIDE	MYRTEZA	VATHI	83	8/907	273.80	30,783	8,428,385.40
581	HAXHIRE	MYRTEZA	VATHI					
582	LAJE	MYRTEZA	VATHI					
583	LUMTURI	SEFER	CIZMJA					
584	NAIM	SEFER	VATHI					
585	SABRIJE	MYRTEZA	DASHI	84	9/209	23.80	34,068	810,818.40
586	XHEMLE	EMIN	VATHI					
587	ADELA	XHEMIL	LLAGAMI					
588	ADNAN		LLAGAMI					
589	ALEKSANDR		LLAGAMI					
590	ARTUR		LLAGAMI					
591	BEHIXHET	TAFAJ	LLAGAMI					
592	ERVIN		LLAGAMI					
593	MIRNIJE	XHEMAIL	LLAGAMI					
594	MYHYRIJE		VERZIVOLLI					
595	NEXHAT		LLAGAMI					
596	SADETE	NEVZAT	LLAGAMI					
597	ADNAN		LLAGAMI					
598	ALEKSANDR		LLAGAMI					
599	ARTUR		LLAGAMI					
600	ERVIN		LLAGAMI					
601	MYHYRIJE		VERZIVOLLI					
602	NEXHAT		LLAGAMI					
603	BAKUSHE	MEHMET	KUSURI	86	224/58	113.80	479	54,510.20
604	BUKURRIJE	XHEMAL	CELNIKU					
605	FATMIR	XHEMAL	CELNIKU					
606	LEME	MEHMET	KUSURI					
607	LULJETA	XHEMAL	SALLAKU					
608	METIJE	XHEMAL	KOCI					
609	MYRTEZA	XHEMAL	CELNIKU					
610	NAILE	MEHMET	KUSURI					
611	OSMAN	MEHMET	KUSURI					
612	QEFERE	MEHMET	KUSURI					
614	HAXHIRE		LULI					
615	ARBEN		LULI					
616	HAXHIRE	ISLAM	LULI					
617	SELIM	RAMIS	LULI					
618	ARBEN	RAMIS	LULI					
619	ENGJELLSHE	RAMIS	LULI					
620	PETRIT	KAMBER	CECA					
621	GERSI	PETRIT	CECA					
622	EUSABETA	NEXHIP	LULI					

Numri i Pronarëve e qe kompensohen	Kompensimi i Pronarëve							
	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
623	PETRIT	MUSTAFA	LULI					
624	VJOLLCA	MUSTAFA	LULI					
625	FLORA	MUSTAFA	LULI	87	224/21	282.20	479	135,173.80
626	FADIL		SHEHI	88	52/20/1	25.40	3,413	86,690.20
627	ERMIRA		XHUNGA					
628	ERIND		XHUNGA					
629	GENC		XHUNGA					
				89	5/1756	1,237.00	11,780	14,571,860.00
630	ÇLIRIM		XHUNGA	90	5/1757	20.00	11,780	235,600.00
631	JOVAN		PJESHKAZINI					
632	MOISI		PJESHKAZINI					
633	JORGJI		PJESHKAZINI	91	43/25	191.00	19,336	3,693,176.00
634	SAFIJE		BLAÇÇARI					
635	FAHREDIN		TELI					
636	LUMNUE		DUSHI					
637	HASUE		TELI					
638	ZYHRA		TELI					
639	AIDA		LEKBELLO					
640	MIRJAN		TELI	92	29/339	450.00	19,336	8,701,200.00
641	LIDA	ANDON	KIKINA	93	7/109	516.7	19,336	9,990,911.20
642	FROSINA		KAVAJA	94	7/327	263.00	19,336	5,085,368.00
643	FROSINA		KAVAJA	95	7/328	19.00	19,336	367,384.00
644	MIKEL	PJETER	BOSHNJAKU					
645	KOSTANDI		BOSHNJAKU					
646	ALEKSANDER	PJETER	BOSHNJAKU	96	7/108	90.00	19,336	1,740,240.00
647	FROSINA		KAVAJA	97	7/328	251.00	19,336	4,853,336.00
648	FROSINA		KAVAJA	98	7/329	15.00	19,336	290,040.00
649	VIOLETA	KOLE	VUKSANI	99	354/3	72.00	1,929	138,888.00
650	MISIM	MUHARRE	SHEHU					
651	LIMAN	MUHARRE	SHEHU					
652	NEXHAT	MUHARRE	SHEHU	100	752/14	207.20	3,560	3,560
653	EMN	HASAN	LEKA	101	752/15	160.00	3,560	3,560
654	ARIAN	HAN	KOÇEJU	102	752/16	129.40	3,560	3,560
655	DYLIBER		MURATI	103	31/61	64.20	324	20,800.80
656	ZENEPE		MURATI					
657	AGIM	NEZR	PEPA	104	51/62	121.80	324	39,463.20
658	MUHARREM		SHTISHI	105	73/35	314.00	490	153,860.00
659	IBRAHIM	KASEM	SPAJA	106	129/2	358.80	479	171,865.20
660	ANESTI	TOSUM	MALO	107	160/38	15.00	3,283	49,245.00
661	DALIP	SULEJMAN	HASA	108	160/42	3.00	3,283	9,849.00
662	BARDHYL	XHABRAHIMI		109	160/27/1	197.00	3,283	646,751.00
663	NATASHA	BARDHYL	META	110	160/41	10.80	3,283	35,456.40
664	MYZEJEN		SEFERI	111	13/561	62.30	33,755	2,102,936.50

Numri i Pronarëve e qe kompensohen	Kompensimi i Pronarëve							
	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
665	EDUART	ENVER	DUSHKU					
666	ALBAN	ENVER	DUSHKU	112	24/9	130.60	2,560	334,336.00
667	ASLLAN		BARDHI	113	2/7	481.40	878	422,669.20
668	ISMAL	SHEFQET	BOGDANI					
669	BUKUROSH	ESAT	ALLA					
670	YLLI	ESAT	MOLLA					
671	SHKELQIM	ESAT	MOLLA					
672	NAILE		BOGDANI					
673	ALMA	SHEFQET	MICI					
674	KUJTIM	SHEFQET	BOGDANI					
675	LUAN	SHEFQET	BOGDANI	114	2/251	7.47	30,783	229,949.01
676	EDLIRA		ROQI	115	1/705	15.12	66,969	1,012,571.28
677	SKENDER		ALLIU					
678	PETRIT		ALLIU					
679	MERIMAN		ALLIU					
680	SABINA		ALLIU					
681	ORINDA		ALLIU					
682	BAFTISHA		ALLIU					
683	BASHKIM		ALLIU					
684	LULJETA		ALLIU					
685	PELLUMB		ALLIU					
686	HOLTA		ALLIU					
687	TERENS		ALLIU	116	7/565	67.98	66,969	4,552,552.62
688	ALGERT	TELHA	NOZZLI	117	317/111	1,305.70	2,560	3,342,592.00
689	DIANA	LEFTER	NAKE	118	178/2	1,490.00	1,880	2,801,200.00
690	MHILL	KOL	SHKEMBI	119	6/686	81.28	8,511	691,774.08
691	NDUE	KOL	SHKEMBI					
692	SAMI		KULAJ					
693	HAMDI		KULAJ					
694	JAHO		KULAJ					
695	KADRIE		KULAJ					
696	DASHMIRE		KULAJ					
697	LIRETA		KULAJ	120	27/46	500.00	10,903	5,451,500.00
698	ENGJELLU		KULAJ					
699	VIKTOR		KULAJ					
700	EDLIRA		KULAJ					
701	DRITAN		KULAJ					
702	PETRO		DARDHA	121	24/275	22.50	10,903	245,317.50
703	JORGJI	FILIP	SKRAMI	122	26/6	564.58	8,300	4,686,014.00
704	DIFE	RAMDAN	SOPAJ					
705	SADIK	ASLLAN	SOPAJ					
706	RASIM	ASLLAN	SOPAJ					
707	NEXHMUE	ASLLAN	MICI (SOPAJ)					
708	NAIM	ASLLAN	SOPAJ					
709	ZENEL	ASLLAN	SOPAJ	123	50/66	137.94	5,280	728,323.20
710	SALI	RAMDAN	SPAHIA	124	301/2	108.52	203	22,029.56
711	Mediha	Demir	Libohova					
712	Çefatije	Demir	Juba					
713	Jalldiz	Demir	Hydi					
714	Ferzilet		Spahiu					
715	Mnerva	Hysni	Jenisher					

Flor Mumajesi: Për ata që duan vërtet jo vetëm një ditë

Ja VIP-at shqiptarë që festuan Shën Valentinin

"Dashuria është luftë e përditshme"

Egla Xhemali

Personazhet e njohur të botës së artit kanë zgjedhur ta kalojnë në mënyra të ndryshme Shën Valentinin. Disa nuk u përkushtuan shumë ndaj festës, ndërsa disa prej tyre preferuan të postonin grima lumturie nga kjo ditë. Simboli i festës së të dashuruarve janë zemrat e kuqe, trëndafilat dhe çokolatat, të cilat nuk kanë munguar as këtë vit.

Reperi Stresi prej shumë kohësh gjendet tashmë në burg, në pritje të gjyqimit të tij. Gjatë gjithë kësaj kohe, pavarësisht aludimeve të shtypit rozë, e dashura e Stresit, Kejsi ka qëndruar në krah tij, duke e shprehur hapur dashurinë. Edhe Dita e Shën Valentinit nuk përfundoi pa një urim special për njeriun e saj të zemrës. Nga Kanadaja, Kejsi i thotë Stresit, se distanca i bën njerëzit të vlerësojnë më shumë atë që kanë:

"Gëzuar Shën Valentinin shpirti im! Kudo nëpër botë të jemi, zemra ime është gjithmonë me ty. Nuk është e rëndësishme t'festojmë sot, sepse çdo ditë për ne është Shën Valentin. Distanca të bën të vlerësosh atë që ke dhe ta mbash përgjithmonë! Sic thotë Shpresa Lushaj, sot dashuria është në fluturim nga Toronto në Shqipëri e anasjelltas. Të Dua!"

Ditën e të dashuruarve e festuan edhe ata. Natyrisht, si çdo vit edhe sivjet çifti më i dashur për publikun kanë zgjedhur një ambient të ngrohtë për të qenë pranë njëri-tjetrit dhe për t'ju gëzuar kësaj dite. Xhensila Myrtezaj bashkë me Besin kanë vendosur që "Shën Valentinin" ta festojnë në një formë të veçantë. Këngëtarja ka hedhur një fotografi në Instagram ku shihet e ulur pranë Besit, me të cilin kishin bashkuar zemrat e ndara në mes. Me këtë veprim, ata lënë të kuptohet se zemrat e tyre do jenë bashkë qdoherë, jo vetëm më 14 shkurt.

Ka dhe nga ata personazhe që ditën e 14 shkurtit "e përdorin" për të konfirmuar statusin e tyre ose për të nxjerrë enigma të tjera. Një veprim të tillë ka bërë edhe Françeska Jaçe. Ajo e ka konfirmuar statusin e saj si single dhe ndoshta të gjithë menduan se në




ditën e shënuar do të zbulonte diçka nga jeta e saj private, por nuk ka ndodhur kështu. Françeska ka uruar Shën Valentinin me arushin e saj: "Me të dashurin tim. Gëzuar Shën Valentinin", shkruan bukuroshja. Edhe njëherë tjetër Françeska na ka lënë në enigmë në lidhje me historitë e saj të dashurisë.

Roza Lati është një nga

moderatore më të komentuar shqiptare, e cila është mjaft e ndjekur në profilin e saj në 'Instagram'. E duke qenë se është një personazh publik që i thotë gjërat në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë, jeta e saj private përbën interes për fansat. Prej disa muajsh kanë qarkulluar foto të ndryshme të saj dhe të partnerit, mirëpo Roza kishte



vendosur ta mbante "të fshtë". Të paktën deri ditën e djeshme, pasi publikoi vetë një foto me të dashurin e saj dhe në këtë mënyrë i uroi festën e Shën Valentinit gjithë të dashuruarve. "Unë dhe partneri im i vetëm në krim ju përhëndesim. Dashuria është një luftë e përditshme, por që ja vlen çdo debat dhe çdo lot për aq kohë që shpirti



im kërkon për ty dhe i jot për mua", ka shkruar Roza përmbi foton ku fytyra e djalit është e mbuluar.

Për të Shën Valentinin festohet çdo ditë, jo vetëm me datën 14 shkurt. Ndër urimet më të ngrohta për festën e të dashuruarve ka bërë dhe kantautori Flori Mumajesi. Këngëtari vendosi ta kujtojë dashurinë e vërtetë me një

pjesë nga kënga e tij "Me fjalë të vogla", këngë kjo që në momentin kur është publikuar u tha se është një dedikim për Elvana Gjatën, ish-të dashurën e tij. "Për ata që duan vërtet jo vetëm një ditë, jo vetëm sot...", shkruajti Flori në postimin e tij në 'Instagram' dhe sigurisht që nuk mund të mungonin as "ngacmimet" e fansave.



Capital T në lidhje? Reperi ka thyer qindra zemra me këtë foto

E dashura" e re e Capital T "do i bëjë xhelozë" të gjitha fansat e tij! Reperi i njohur Capital T është një artist shumë i dashur për publikun dhe vazhdon të jetë mjaft aktiv në rrjetet sociale. Ai përipiqet që nëpërmjet postimeve në 'Instagram' të qëndrojë sa më pranë fansave duke ndarë me ta momente nga jeta e tij e përditshme. Megjithatë, si gjithë personazhet e tjerë, edhe Capitali ditën e djeshme ka publikuar një foto për festën e Shën Valentinit. Këngëtarja është fotografuar me një arush pellushi në krahe, ndërkohë që në përshkrim të fotos ka sqaruar, që ky arush është dashuria e tij. "Bae për sot", ka shkruar Trimi pranë fotos, e cila është komentuar gjatë, pasi të shumë janë ata që e kanë pyetur nëse kjo është një dhuratë për të dashurën apo jo.



I fshiu komentin Feros, ja detaji që i habiti fansat

Mund të themi pa frikë se Fero dhe Arbenita janë kthyer ndër çiftet më "IN" dhe të komentuar të showbiz-it shqiptar. Shpesh dyshja përfillet për marrëdhënien e tyre dhe Arbenita është shumë aktive dhe mjaft e ndjekur në rrjetet sociale me fotot e saj, të cilat tërheqin vëmendjen e të gjithëve. Por, diçka që na ka bërë përshtypje është se modelja seksi gjithmonë kur poston foto me reperin e famshëm Fero, fshin të gjitha komentet ose të paktën bën 'turn off' komentet. Të njëjtën gjë ka bërë edhe këtë herë në postimin e saj ku ka dalë në foto krahe Feros dhe si mbishkrim ka një trëndafil të kuq si emoji.



Vis Bajraktari i thotë "Jo" Lori Hoxhës, zbuloni të vërtetën

U ktheje në një "telenovelë", por më në fund u sqarua gjithçka! Prej disa ditësh në portale e media të ndryshme, Lori Hoxha dhe Vis Bajraktari kanë qenë dy ndër personazhet më të përfolur pasi u tha lart e poshtë se ata mund të jenë ndarë. Dyshimet u shtuan pasi fansat vunë re që ata nuk ndjekin njëri-tjetrin në rrjetet sociale, por edhe ngacmoheshin shpesh me postime të ndryshme. Ata nuk reagojnë asnjëherë rreth këtyre lajmeve dhe i pari që "e theu akullin" ishte pikërisht Vis Bajraktari. Ky i fundit ka publikuar dy video në Snapchat, ku shfaqet duke dëgjuar në radio teksa flitet për një ndarje të mundshme mes tij dhe Lorit. E kur moderatorja thotë që Lori me anë të një postimi ka dashur t'i thotë Visit: "Nuk je vetëm edhe pse jemi ndarë", ai shkroi me ironi: Ashtu më mirë, vazhdo programin! S'e kuptuam tamam çfarë deshi të tregonte Visi me këtë, por mund ta marrim më shumë si një "Jo" nga ana e tij!



"Krejt t'i fal", kujt ia drejton Luana këto fjalë?

Moderatorja dhe këngëtarja e njohur ka publikuar një foto nga klipi i saj i ri që do publikohet shumë shpejt e siç duket vendosi edhe një pjesë të tekstit si përshkrim: "Afër ty me t'pas.. krejt t'i kisha fal. Gëzuar ditën e Shën Valentinit", shkruan bukuroshja. Por kë do të ketë afër Luana? Këtë me siguri s'do e marrim vesh edhe pse ajo flitet se është në një lidhje me Krenar Çoçajn. Mirepo një detaj që na bëri përshtypje është look-u i ri i këngëtares, e cila është kthyer sërish brune për xhirimet e klipit të ri muzikor. Luana publikoi një tjetër foto me këtë ndryshim në pamje dhe zgjodhi një tjetër përshkrim interesant. Epo mesa duket kënga e re e Lu-anës, siç duket, do ketë një tekst për të dashuruar.



Vuçiç për taksën: Do presim edhe pak, e pastaj të shohim

Hashim Thaçi: S'ka viza nëse nuk pezullohet tarifa e mallrave e vënë ndaj Serbisë



Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç, në lidhje me taksat kosovare në prodhimet serbe ka thënë se do të presim edhe pak kohë dhe e më pas duhet të ulemi dhe të shohim se si do veprojmë më tutje. Ai theksoi se është i shqetësuar për shkak të papërgjegjësive së politikanëve shqiptarë dhe se nuk është optimist në pikëpamje të zhvillimit të situatës në Kosovë. "Për mua është problem i madh e që po shndërrohet në vetëm po përpiqemi ta ruajmë paqen dhe të gjejmë një zgjidhje sa më të mirë për të dyja palët. I falën-

derojë partnerët perëndimorë në përkrahje që kjo të sigurohet", ka deklaruar Vuçiç. Presidenti i Serbisë nga ana tjetër tha se është e pakumtimtë të bisedohet për diçka tjetër përveç taksës me Kosovën. "Nëse nuk jemi në gjendje të kemi qarkullim të lirshëm të mallit për çfarë të bisedojmë, shumë njerëz në Kosovë nuk e kuptojnë këtë. Aq shumë jam i bren-gosur për shkak të marrëdhënieve tona të këqija,

sagë do të doja të lavdërohem që së paku kam arrit diçka në mënyrë të fshehtë, por për fat të keq jo. Nuk është sekret kur takohemi të kancelari austriak Sebastian Kurc. Sebastiani m'i tregon fotografite, në Nju Jork Frederica Mogherini po organizon darkë të përbashkët, çfarë unë duhet të bëjë", ka shtuar Vuçiç. Nga ana tjetër, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka deklaruar se nuk ka pasur përplasje mes tij

dhe kryeministrit Haradinaj në lidhje me taksën ndaj Serbisë. "Në raport me taksën nuk kemi pasur në asnjë rrethanë. Partnerët e koalicionit duhet të diskutojnë duke pasur parasysh që e ardhmja e Kosovës është e lidhur ngushtë me ShBA-në. Mikmund të jesh kur i respekton këshillat, nuk e mohoj amerikanizim e liderëve, por në të njëjtën kohë respekti duhet të jetë i ndërsjellë dhe jo i njëanshëm", është shprehur Thaçi në RTK. Thaçi ka thënë po ashtu se ai ka rekomanduar që të ndodhë pezullimi i përkohshëm i taksës ndaj mallrave serbe. "Unë kam shprehur këshillën time, por edhe rekomandimin që të

ndodhë një pezullim të përkohshëm", ka thënë ai. Më tej Thaçi ka folur edhe për sanksionet që mund të ndërmerren nga ShBA-ja dhe BE-ja kundërt Kosovës nëse nuk pezullohet taksa. Ai ka thënë se në këtë rast nuk do të ketë liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës nga BE-ja. "Mund të kemi masa që do të ndërmerren nga SHBA dhe BE dhe këto masa nuk i meritojnë qytetarët e Kosovës. Nga BE nuk do të ketë liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës dhe do të ketë masa që do të jenë shqetësues për qytetarët e Kosovës edhe pse nuk po dua t'i dramatoz", është shprehur Thaçi.

Tragedia në rrugën Shkup-Gostivar, Zaev: Dhimbja e pikëllimi s'mund të maten

Aksidenti në Maqedoni, detaje të reja nga fatkeqësia me 14 të vdekur

Flet ministri si dëshmitar: Kërceu për të mbajtur timonin e shoferit

Ditën e djeshme, Prokuroria Themelore Publike në Shkup së bashku me ekipin e MPB-së kanë përfunduar aktin e ekspertizës në vendin e aksidentit tragjik ku humbën jetën 14 persona. Aksidenti i rëndë u shënuar gjatë mbledhjes së të mërkurës në rrugën që lidh Shkupin me Gostivarin. Banorët e fshatit Llaskarcë dhe fshatrave tjera përreth kanë dalë në vendngjarje dhe kanë ofruar ndihmë të jashtëzakonshme. Të aksidentuarit janë transportuar për në spital edhe me helikopterë. Hetimet dhe ekspertiza kanë konfirmuar se shoferi i autobusit nuk ishte nën efektin e alkoolit. "Intensivisht punohet në vërtetimin e të gjitha detajeve, të cilat do të mund të zbulonin shkaqet e aksidentit. Autobusi i kompanisë "Durmo Tours" është marrë nga vendi i ngjarjes dhe me urdhër të Prokurorit Publik mbi të do të kryhet kontrolli teknik i detajuar nga ana e Fakultetit të Makinerisë në Shkup. Nga informatat e deritanishme fletet se bëhet fjalë për autobus të vitit 2001, dhe se për herë të fundit ka qenë i regjistruar në janar të viti 2019. Shoferi, i cili ka drejtuar autobusin është shtuar në spital dhe ka marrë lëndime në trup. Menjëherë pas aksidentit prokurori publik realizoi një bisedë me të dhe gjatë kësaj ai ka nuk ka dhënë detaje për ngjarjen. Prokurori publik është njoftuar gojorishit se analizat e gjakut dhe të urinës flasin se në momentin e aksidentit tek shoferi nuk është regjistruar prezenca e alkoolit, barnave apo substancave psihotropike. Në kërkuesin e tabulateve nga operatorët telefonikë do të vërtetohet nëse shoferi në momentin e aksidentit ka shfrytëzuar telefonin celular", thuhet në njoftim. Për shkak të tragjedisë së madhe që ndodhi ditën e mërkurë në orët e pasdites në rrugën Shkup-



Pamje nga aksidenti i autobusit i ndodhur në rrugën Shkup - Gostivar

BEJTULLA NUHIU

"Isha në karrigen e tretë ulur, u ngrita në këmbë thashë mos e zuri gjumi shoferin, ose ndodhi diçka. E pashë shoferin, ishte shtrënguar prej timoni. Kërcej tek shoferi që të mbaj drejtimin, por në atë rast e humbi drejtimin. Në fillim kemi filluar t'i nxjerrim personat që kanë thërritur për ndihmë, që kanë qenë në anën poshtë të autobusit dhe me vetura private i kemi shpërndarë në spitale më të afërta", ka thënë Nuhiu.

Tetovë, qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pas përfundimit të seancës së jashtëzakonshme ka njoftuar se data 14 dhe 15 shkurt do të jetë ditë zie. Këtë vendim e ka njoftuar vetë kryeministri Zoran Zaev, i cili mes tjerash ka shtuar se numri i viktimave ka arritur

në 14. Në Klinikat e Shkupit, ekipe të shumta mjekësore janë të angazhuar në mjekimin dhe operimin e mbi 30 të lënduarve nga aksidenti tragjik. Aksidenti ka ndodhur në autostradën Shkup-Tetovë, në kilometrin e shtatë të saj. Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev

përmes profilit të tij në 'Facebook' ka shprehur ngushëllime familjarëve të viktimave në aksidentin e rëndë që ka ndodhur në autostradën Shkup-Tetovë, ku 13 persona kanë humbur jetën, ndërsa dhjetëra të tjerë kanë mbetur të plagosur. "Dhimbja dhe pikëllimi nuk mund të maten dhe nuk ka fjalë që mund të ngushëllojë aksidentin e rëndë që ishte fatale për shumë nga bashkëqytetarët tanë. Ngushëllime deri tek me të dashurit e tyre. Po mobilizojmë të gjitha forcat dhe kapacitetet për të ndihmuar të gjithë të tjerët që janë në rrezik për jetën në mënyrë që sa më shpejtë të kthehen tek të dashurit e tyre", ka shkruar Zaev. Bejtulla Nuhiu i punësuar në Ministrinë

ZORAN ZAEV

"Dhimbja dhe pikëllimi nuk mund të maten dhe nuk ka fjalë që mund të ngushëllojë aksidentin e rëndë që ishte fatal për shumë nga bashkëqytetarët tanë. Ngushëllime deri tek me të dashurit e tyre. Po mobilizojmë të gjitha forcat dhe kapacitetet për të ndihmuar të gjithë të tjerët që janë në rrezik për jetën në mënyrë që sa më shpejtë të kthehen tek të dashurit e tyre", ka shkruar Zaev.

Kongresmeni amerikan: S'ka integrim në BE për Serbinë pa njohur Kosovën

Ndërkohë që dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, duket sikur ka ngrirë, kongresmeni amerikan, Eliot Engel ka paralajmëruar Serbinë se nuk do të ketë integrim në Bashkimin Evropian pa njohjen e Kosovës. Engel iu referua apelit të ambasadorit gjerman Christoph Heussen në Këshillin e Sigurimit, që tha se Kosova është e pavarur, dhe njohja e këtij realiteti është e vetmja mënyrë që Serbia të ecë përpara në rrugën drejt Evropës. "Serbia duhet t'i trajtojë me shumë kujdes fjalët e ambasadorit gjerman Christoph Heussen në Këshillin e Sigurimit të bëra të enjten, sepse nuk do të mund të integrohen në Bashkimin Evropian derisa nuk e njohin Kosovën", u shpreh ai. Njohja e Kosovës nga ana e Serbisë duket një realitet i largët në kushtet ku mes vendeve ka një debat për tarifën ndaj produkteve serbe. Po ashtu edhe teza e korrigjimit të kufirit mban pezull njohjen reciproke.

Kriza ekonomike po thellohet, Maduro nuk pranon ndihma nga SHBA

Realiteti i hidhur, Venezuela po përballet me krizë të thellë humanitare në vend



P prej kohësh banorët e Venezuelës po përballet me mungesë drastike të ushqimit, përderisa kriza ekonomike po thellohet. Presidenti i kontestuar, Nicolás Maduro i tha BBC-së se nuk do të lejohet ndihmat për banorët, pasi pretendon se ato janë një mjet i Shteteve të Bashkuara për të ndërhyrë në Venezuelën. Udhëheqësi i opozitës, Juan Guaidó, i cili është njohur nga SHBA-ja dhe qeveritë perëndimore si president i përkohshëm i Venezuelës, gjatë një tubimi në kryeqytetin Karakas, ka premtuar se do të sigurojë që ndihmat humanitare, që janë bllokuar nga presidenti Maduro, të hyjnë në vend. "Ne kemi pothuajse 300,000 banorë të Vene-

manitare do të sillen në Venezuelë më 23 shkurt. Të dërguarit e Guaidos u takuan me zyrtarët brazilianë këtë javë dhe njoftuan për planet për të krijuar një qendër të dytë të depozitimit të ndihmave në shtetin e Roraima, në kufirin juglindor të Venezuelës. Kamionët me ndihma humanitare të SHBA-së arritën javën e kaluar në qytetin kufitar Kolumbu, por u ndaluan në urën Tienditas, e cila është bllokuar nga trupat venezueliane të kontrolluara nga Maduro. Presidenti i kontestuar Maduro ende gëzon përkrahje të gjerë në mesin e popullatës

dhe besnikërinë e ushtrisë, përderisa qeveria e tij e majtë mbështetet nga Rusia dhe Kina. Por, ai është nën presion kombëtar dhe ndërkombëtar për të thirrur zgjedhje të parakohshme presidenciale, mes akuzave për korrupsion të përhapur dhe shkeljet të të drejtave të njeriut nën udhëheqjen e tij. Marrëdhëniet me SHBA-së dhe Venezuelës ishin të tensionuara përpara se administrata e presidentit Donald Trump të bëhej një nga të parët që do të mbështeste liderin e opozitës, Juan Guaidon si udhëheqës të përkohshëm.

Venezuela ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me SHBA-në, ndërsa presidenti Trump tha se përdorimi i forcës ushtarake mbetet "një opsion". SHBA e ka akuzuar Qeverinë e Maduros për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe korrupsionin. Rusia, të martën, ka paralajmëruar Shtetet e Bashkuara kundër ndërhyrjes në punët e brendshme të Venezuelës. Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov i bëri komentet gjatë një telefonate me Sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, njoftoi Ministria e Jashtme e Rusisë. Departamenti amerikan i Shtetit nuk e ka konfirmuar zhvillimin e bisedës telefonike. Moska i ka dhënë miliardë dollarë ndihmë qeverisë së presidentit të kontestuar, Nicolás Maduro. Megjithatë, Venezuela ka rënë në kaos ekonomik.

SHKURT

Filipine, në pranga gazetarja investigative e CNN

Maria Ressa, një ndër gazetarët investigative me famë botërore shoqërohet në polici në vendin e saj të lindjes Filipine. Agjentët e zyrës kombëtare hetimore shkuan në zyrat e portalit të saj investigativ Rappler në Manila. Ressa është kritike ndaj presidentit Rodrigo Duterte. Ajo akuzohet për shpifje të shumëfishta, bazuar në një ligj të miratuar në vitin 2012 kundër shpifjeve në portalet në media online. Akuzat për të cilën u arrestua është një shkrim investigativ që daton 4 muaj para miratimit të këtij ligji në vitin 2012. Shkrimi hidhte dritë mbi një aferë korruptive mes një biznesmeni dhe një gjykatësi. Hetimi u hap fillimisht në vitin 2016, por u mbyll në atë kohë për mungesë të mjaftueshme provash për t'u rihapur vitin e kaluar. Maria Ressa ka qenë prej vitësh bashkëpunëtorë e CNN në Manila dhe është shpallur ndër gazetarët e vitit për 2018-ën nga revista prestigjioze "Time".

Itali, dhunohet nga mafiozët gazetari i RAI

Daniele Piervincenzi, gazetari i televizionit publik italian Rai dhunohet nga pjesëtarët e bandave të shpërndarësve të drogës. Piervincenzi dhe grupi i xhirimit ndodheshin mes një blloku pallatesh në periferi të Peskarës për të kryer një reportazh investigativ mbi trafikimin e lëndëve narkotike në lagjen Ater, e konsideruar si kryeqendra e shpërndarjes së drogës për qytetin dhe gjithë rajonin e Abrucos. Pre e dhunës së ekspozitëve të botës së krimi, Piervincenzi ra edhe në nëntor të 2017-s, kur u godit nga Roberto Spada, vëllai i një bosi mafioz në periferi të Romës, i cili i theu hundën. Një vit më parë, një tjetër gazetar e Raid, Mariagrazia Maxola u godit me shuplakë nga bashkëshortja e një bosi droge në Bari.

Pesha e fjalës së lirë, 'koka e turkut' e gazetarëve të vrarë

4 vite pas sulmit, tradhtia ndaj Charlie Hebdo

Solidariteti me 'Unë jam Charlie', çfarë fshihet pas parullës



K atër vjet më parë, disa xhihadistë hynë me forcë në zyrat e revistës "Charlie Hebdo" në Paris, dhe qëlluan për vdekje 10 anëtarë të stafit, një oficer policie dhe një roje sigurie. Menjëherë pas masakrës, mijëra njerëz u derdhën rrugëve për të përkujtuar gazetarët e vrarë. Globalisht, në mediat sociale, shumica i bënë jehonë sloganit 'Je Suis Charlie', në shenjë solidariteti. Por kur ai moment kaloi, u bë e qartë se kërcënimet ndaj lirisë së fjalës buron jo vetëm apo kryesisht nga "vetoja" e xhihadistëve. Problemi më i thellë jemi vetë ne. Ekziston një antipati e përhapur ndaj parimit të lirisë së shprehjes. Nëse nuk e kuptojmë dhe e vlerësojmë, do ta humbasim këtë të drejtë vendimtare. Që nga pasojat e masakrës së Charlie Hebdo, është bërë e qartë se fjala e lirë gjendet nën kërcënim nga inteligjencia kryesore, si dhe islamikët e dhunshëm. Së pari, ka pasur reagim kundër vetë Charlie Hebdo. Ndërsa shumë njerëz shprehën solidaritet, të tjerët u morën me satirizimin e shpesh të revistës së bente Islamit me paraqitjen e karikaturave të Profetit Muhamed. Fjala e lirë, është e drejta për të shprehur idetë vetjake, pa frikën e ndëshkimit, edhe nëse të tjerët nuk bien dakord me ju - edhe nëse ndihen të fyer. Kjo e drejtë i lë njerëzit të lirë të kundërshtojnë, dhe të lirë të bindin të tjerët për idetë e tyre. Asnjë pikëpamje politike, fetare apo ideologjike, nuk duhet të lejohet si një përjashtim i veçantë nga sfera, kritika apo tallja. Por sapo u zbeh vrulli i fushatës 'Je Suis Charlie', zërat e shquar nisën të fajësojnë vetë revistën për sulmin. Kur "PEN America", një organizatë e shkrimtarëve në SHBA, vendosi t'i jepte Charlie Hebdo, cmimin e Lirisë së Shprehjes dhe Kurajos, më shumë se 200 shkrimtarë të mirënjohur protestuan. Dekani i një shkolle

të gazetarisë, duke shkruar në "USA Today", nënkuptonte se satirat e revistës ndaj profetit Muhamed, duhet të lihen jashtë mbrojtjes nga Amendamenti i Parë. Dhe Geri Trudo, krijuesi i ilustrimeve komike Doonesbury, sugjeroi se Charlie Hebdo kishte nxitur dhunën vrastare kundër vetes. Refuzimi i fjalës së lirë, ka qenë, gjithashtu, i dukshëm në një vend tjetër në shoqëri. Debatet mbi fjalën e lirë në kampuset universitare, janë shpeshuar që nga masakra e Charlie Hebdo. Në Berkli, studentët protestuan në vitin 2017 për të parandaluar një aktivitet, duke shkakuar 100 mijë dollarë dëme. Në

Middlebury College, studentët ndërprejnë në mes një aktiviteti promovues mbi shkrimtarin kontrovers, Carls Marvej, duke plagosur një anëtar të fakultetit. Një çështje e rëndësishme në këto polemika, është pikëpamja e një numri alarmues studentësh se fjalët janë dhunë. Shumë studentë sot, mendojnë se dëgjimi i ideve që sfidojnë idetë e tyre, është i barabartë me një sulm fizik. Ata me dashje e turbullojnë vijën ndarëse midis fjalës dhe veprimt. Kjo është vërtetë diçka oguruzë, pasi legjitimiton përdorimin e forcës, për të heshtur zërat me të cilët nuk pajtohem. Sondazhet tregojnë se ndërsa pak studentë, do të

ishin vetë të gatshëm të përdorin dhunën për t'i mbyllur gojën një folësi, 19-30 për qind e tyre, besojnë se është e justifikueshme që studentët e tjerë ta bëjnë diçka të tillë. Sulmi ndaj fjalës së lirë po vjen edhe nga e djathta. Presidenti Donald Trump, jo vetëm është përplasur me mediat. Ai ka shprehur një antipati më të gjerë ndaj Amendamentit të Parë. Ai ka sugjeruar që ligjet federale mbi shpifjen duhet të zgjerohen, me sa duket në mënyrë që ai të ketë mundësi të përndjekë kritikët e tij. Ai, gjithashtu, ka kërcënuar të

anulojë licencat e transmetimit, si një formë ndëshkimi për mbulimet mediatake të pafavorshme ndaj tij. Kur shohim më gjerë, atëherë është e qartë se kërcënimet ndaj fjalës së lirë, është shumë më i gjerë sesa thjesht kërcënimet xhihadist. Para se të mbështesim fjalën e lirë, ne duhet ta kuptojmë atë. Ne duhet ta vlerësojmë vlerën e saj në avancimin e jetës, njohurive dhe përparimit të njeriut. Katër vitet nga masakra në Charlie Hebdo, na kanë treguar se kemi ende shumë rrugë për të bërë. Marrë nga "Spiked" - Bota.al

PASAGJERËT KALOJNË TMERR NË AEROPLAN NË "FLUTURIMIN E FERRIT"

Pesë persona pësuan lëndime për shkak të turbulencave të forta në ajër gjatë fluturimit nga Uashingtoni në Kaliforni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Tre prej personave të lënduar u dërguan në spital për kontroll mjekësor. Brenda aeroplanit ishte një rrëmujë e vërtetë. Sende dhe valixhe të rrëzuara përtokë për shkak të turbulencave. Pasagjerët thonë se ekuipazhi i avionit e menaxhoi me kujdes dhe në mënyrë perfekte situatën e krijuar.



FOTOLAJM

35-VJETORI I VDEKJES

GJON MILI

Gjeniu shqiptar i fotografisë në dhjetëshen botërore

Fahredin Spahija

Revista amerikane "Popular Photography", që dikur konsiderohej si më e madhja e llojit të vet në Amerikë dhe jashtë saj, numrin e parë e publikoi më 1937. Gjatë historisë 80-vjeçare, veç informacioneve për artin dhe zhvillimin teknologjik të fotografisë, revista ishte edhe prapë prapë në prezantimin e fotografëve më të mirë të kohës - si në Amerikë, ashtu edhe në botë.

Në vitin 1958, në publikimin e muajit maj, redaksia e kësaj reviste kishte botuar rezultatin e një ankete për fotografët kryesorë aktivë të kohës, duke e nxjerrë listën e 10 më të mëdhenjve. Për të dëshmuar se nuk anojnë për asnjë emër, redaksia listën e publikon sipas këtij rendi alfabetik: 1. Ansel Adams; 2. Richard Avedon; 3. Henri Cartier-Bresson; 4. Alfred Eisenstaedt; 5. Ernst Haas; 6. Philippe Halsman; 7. Yousuf Karsh; 8. Gjon Mili; 9. Irving Penn dhe 10. W. Eugene Smith.

Siç shihet, në listë është edhe emri i gjenitit shqiptar të fotografisë, Gjon Mili, i cili në mesin e shekullit XX ka shkruar një nga faqet ma të lavdishme të historisë së fotografisë amerikane dhe asaj botërore.

Vlerësimi - apo përzgjedhja e këtyre emrave - është rezultat i sondazhit në të cilin janë përfshirë kritikët, mesimdhënësit, redaktorët, drejtorët artistikë, konsulentët dhe fotografët e angazhuar brenda dhe jashtë vendit. Nga 465 autoritetet të kontaktuar, 243 prej tyre i janë përgjigjur sondazhit.

Sondazhi për dhjetë më të mëdhenjtë e fotografisë botërore, zgjoi sa reagime pozitive aq edhe dyshuese nëpër gazetaret që botoheshin asokohe në Amerikë. Nga to vlen të veçohet reagimi i gazetarit Jacob Deschin, i cili në artikullin e botuar në të përditshmen "The New York Times", më 6 prill 1958, ngre disa pikëpyetje lidhur me sondazhin e realizuar nga revista.

"Lista duket sikur u krijua rastësisht, pa ndonjë seriozitet, duke u mbështetur vetëm në reputacionin e fotografit. Për më tepër, në përzgjedhje duket se kanë ndikuar kryesisht pjesëmarrësit amerikanë, duke i dhënë listës frymë nacionale - e jo botërore, siç pretendohet", ka thënë ndër të tjera Deschin.

Pavarësisht reagimeve që vënin në pikëpyetje listën e "dhjetë më të mëdhenjve" të fotografisë botërore, për lexuesin shqiptar - por edhe për historinë e fotografisë shqiptare - publikimi i sondazhit nga revista e sipërpërmendur, na sqaron një moment të panjohur për jetën dhe karrierën e fotografit shqiptaro-amerikan, Gjon Mili. Mili u lind më 28 nëntor 1904, në Korçë, nga prindërit Vasil Mili dhe Viktori Çekani. Me ndihmën e dajës së tij, Koço Çekani, si 18-vjeçar emigron në Amerikë. Daja e ndihmon financiarisht, derisa nuk i



Gjon Mili (foto e bërë nga: Henri Cartier-Bresson)

Për shqiptarin që shkroi një nga faqet më të lavdishme të historisë së fotografisë amerikane dhe asaj botërore

mbaron studimet në Institutin e Teknologjisë të Massachusetts-it. Në këtë universitet prestigjioz ishte ndër studentët më të dalluar, për çka rekomandohet të fillonte punën si inxhinier në kompaninë e famshme të prodhimeve të mjeteve ndriçuese, Westinghouse Lamp Company. Për dhjetë vjet sa punoi në këtë kompani, do të vlerësohet si një nga punëtorët më të zotët dhe më inventivë.

Në vitin 1937 Mili do të njihet me profesorin Harold E. Edgerton - njeriun i cili zbuloi flashin elektronik dhe atë stroboskopik. Mes tyre nis një miqësi dhe bashkëpunim i gjatë, që do të shtyjë Milin të kombinojë elektronikën me fotografinë. Në vitin 1938, falë kësaj miqësie - dhe pas sugjerimit të Edgertonit për ta krijuar një portfolio me fotografi stroboskopike - fotografi shqiptar fillon punën në revistën e famshme LIFE.

Fal punës kreative dhe novative, Mili shpejtë do të bëhet fotografi më i dalluar jo vetëm në LIFE, por edhe në komunitetin artistik amerikan dhe evropian. Kështu, në vitin 1949, gjatë realizimit të një reportazhi për artistët më të mëdhenj pamorë të shekullit XX, Gjon Mili takon Pablo Picasson në shtëpinë e tij në rivierën franceze. Aty ai realizon një varg fotografish me teknikën e tij origjinale, ku më e famshmja mbetet ajo që do të quhet: "Picasso duke vizatuar Kentaurin me dritë". Një vit më vonë, në janar të vitit 1950, koleksioni i fotografive me Picasson ekspozohet në Muzeun e famshëm të New Yorkut,

MoMA, ku do të përcillet me kërshëri të jashtëzakonshme si nga kritika ashtu edhe nga publiku amerikan.

Në vitin 1966, Gjon Mili përjeton një tragjedi: shkaku i instalimit të vjetër të rrymës elektrike, studion e tij në Rrugën 23 të New Yorkut e kaplojnë flakët e pakontrolluara, të cilat ia shkatërrojnë dy të tretat e materialeve të vlefshme (fotografi, negativë, dokumente e letërkëmbime të rëndësishme). Gjatë përpjekjes për ta shuar zjarrin e madh në studion e tij, vdesin 12 zjarrfikës.

Gjatë karrierës mbi 45-vjeçare artistike, Mili realizon edhe disa filma të shkurtër artistikë, nga të cilët duhet të veçohet ai kushtuar

xhaz muzikantëve të mëdhenj të kohës, "Jammin' the Blues". Shkaku i vlerave artistike dhe risive regjisoriale, ky film u nominua për çmimin Oscar në edicionin e vitit 1944.

Për veprën fotografike të Gjon Milin janë botuar tre libra. Në vitin 1960 botohet libri "The Magic of Opera" - libër ky i panjohur deri tani për opinionin shqiptar, që i kushtohet historikut të Operës Metropolitane. Tri të katërtat e këtij libri janë të ilustruara me 68 fotografi të Milin, nga të cilat duhet të veçohet ajo e divës së operës botërore, Maria Callas. Tekstin e librit e ka shkruar kritikja e teatrit dhe muzikës, Mary Ellis Peltz. Në vitin 1970 botohet libri "Picasso's third dimension", i redaktuar nga vet Gjon Mili, ku përfshihen fotografi të realizuara nga dy vizitat - më 1949 dhe më 1967 - që ia ka bërë piktorit më të madh të shekullit XX. Libri përfshin serinë e fotografive të "vizatimit me dritë",

disa portrete - në mesin e të cilëve është ajo emblematikja, e Picassos me lulen e kuqe në vesh - si dhe fotografitë e dhjetëra veprave artistike që piktori i kishte në atelienë e tij. Teksti shpjegues i Milin karakterizohet nga një stil i rrjedhshëm dhe lehtë i kuptueshëm. Në vitin 1980 botohet vepra "Gjon Mili - Photographs & Recollections", që mund të konsiderohet si libër monografik i gjenitit shqiptar, i botuar tërësisht nën mbikëqyrjen e tij. Në tekstin e shkruar nga vet Mili, shpjegohet rrugëtimi i tij krijues - qysh nga fotografia e tij e parë artistike e realizuar në vitin 1931 (portreti i çelistes Margaret Aue), si dhe porrosia e parë e bërë nga revista LIFE në vitin 1938 (ku portretizohet kampioni i tenisit në SHBA, Bobby Riggs).

Qysh në fillim të tekstit të kësaj monografie, Mili përmend shoqërimin e tij me Faik Konicën, për të cilin thotë se "ishte një shok i moshuar shqiptar; një shkrimtar i shkëlqyer; një humanist dhe një intelektual i mprehtë". "Konica ka marrë mundin për të zgjeruar interesimin tim për artet, sidomos për filmat, të cilët i pëlqente dhe i konsideronte si një formë artistike më rëndësi...", ka shkruar ai.

Më tej Mili shprehet se kjo monografi nuk do të realizohej pa ndihmën e miqve në LIFE, të cilët ia ofruan tërë arkivin fotografikë me autorësinë e tij, pasi shumica e fotografive në pronësinë e tij ishin shkatërruar në zjarrin e vitit 1966. Libri përmban një numër të madh të kryeveprave të tij, duke filluar nga portreti i Picassos, nudoja që zbrit shkallëve (vepër e frymëzuar nga një piktorë e artistit konceptual, Marcel Duchamp), balerinave të fotografuara me stroboskopi (të cilat e impresionuan Picasson në takimin e parë), portreti i çelstit Pablo Casals, dramaturgut Sean O'Casey, regjisorit Alfred Hitchcock, pianistit Artur Schnabel, piktorit Henri Matisse, këngëtarit Frank Sinatra, shansonieres Edith Piaf dhe shumë emrave të tjerë të mëdhenj të artit dhe të kulturës botërore...Libri përfundon me një portret që Gjon Mili ia kishte realizuar fotografi i madh francez, babai i asaj që njihet si "Fotografi e rrugës" dhe si autori i librit eseistik "Çasti vendimtar" - i cili udhëzon për një qasje ndryshe në fotografinë bashkëkohore - Henri Cartier-Bresson (të cilin Mili me shaka e urreiste "amator") Pas një sëmundjeje nga pneumonia, Gjon Mili vdiq më 14 shkurt të vitit 1984, në Stamford-Connecticut të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Dhjetë më të mëdhenjtë e fotografisë botërore të shpallur nga revista "Popular Photography"

FILMI



ARDIAN NDRECA:

Arti i bindjes, kur flitej për fenë, kanunin e sheriatin si një trup të vetëm

Fatmira Nikolli

Shfaqet filmi "Në flakët e revolucionit", si u bë Shqipëria shtet ateist

Si u vunë priftërinjtë dhe imamët para gjyqeve publike dhe shembja e kishave e xhamive

Ndjejat qartë arti i bindjes, madje ka edhe efekt. Ndër skenat e para që shfaqet në dokumentar, është mitingu. Dhe ne e dimë se mitingu është vendi tipik ku avullon personaliteti i njeriut. Njeriu humb personalitetin dhe përgjegjësinë. Në taktikën e komunikimit ka një konfuzion të vazhdueshëm. Konfuzioni është i dëshiruar nga personat që duan të mashtrorjnë. Konfuzioni bën që të pranohet diçka jo e vërtetë si diçka e vërtetë. Flitet për fenë, kanunin, sheriatin, patriarkalizmin, frikërat, supersticionet, zakone prapanike që janë gjëra krejtësisht heterogjene. Nuk mund të trajtohen të gjitha sikur të ishin një trup i vetëm. Ka dhunë të vazhdueshme. Feja trajtohet si ideologji, por nuk është ideologji...".

Ardian Ndreca analizon imazhin që përcjell një film për të treguar truket e përdorura gjatë regjimit komunist. Shkas bëhet filmi dokumentar i realizuar më 1967 "Në flakët e revolucionit". Ai tregon se si Shqipëria e mbyllur nga bota, shpallet vend ateist, duke iu veshur feve gjithfarë epiteteve që do të justifikonin ndalimin e besimit, shembjen e objekteve të kultit dhe eliminimin e klerit që ishte ndër kundërshtarët e parë të komunistit.

Gjithë kjo, do të forconte kultin e individit e do të shquante më shumë qoftë edhe në pavetëdije imazhin i diktatorit, si "zoti" i ri, tani më kur të vjetrin e vranë.

Duke krijuar një zot të ri që i veshën tiparet e të plothuqishmit në tokë, si një njeri të prekshëm që kishte çiruar vendin, ata i drejtuan turmat kundër besimit. E vranë ndërgjegjen e një besimtari, vranë njeriun që besonte në të mirën dhe



në të keqen, për të krijuar njeriun që besonte në komunizmin dhe ateizmin. Ata e vranë njeriun dhe krijuan armikun, vranë njeriun dhe krijuan kundërshtarin që mund të ishte kudo, ndaj sekush ishte në luftë me këdo- duke treguar vigjilencë.

Por si u arrit të bëhej Shqipëria vendi i parë ateist në botë?

Ardian Ndreca tha se "fryma revolucionare nis me celulatat dhe mbaron tek celuloidi. Fitoret e propagandës komuniste janë fitore celuloze, jo fitore që ndodhin në të vërtetë... Vetë zëri i folësit është i njëtrajtshëm, nuk ka emocion edhe nuk shihet, por nuk ka asnjë lloj problemi. Filtri është folësi". Për Ndreca "ligjërimi është i përsosur, por ne nuk e dimë atë që thonë në të vërtetë ata... Një formulë pagëzimi e re, një zë, një identikit i ri që mundohet që të krijohet".

Studiuesi Ndreca ndalet edhe te mistifikimi që në këtë film, paraqitet në mënyrë të pastër.

"Është e pamundur që të bësh një



film të tillë edhe mos të mistifikosh. Nuk mund të ketë një vërtetë që paraqitet në formë kaq të pastër. Manastiret, Frika e xhindeve në manastir: Traktatet e para kundër magjive janë shkruar nga njerëzit e fesë. Feja e krishterë e trajton si armikun e vet supersticionin ose magjinë. Thuhet se Pal Doda, Gjon Shllaku kanë pas qëllime terroriste. Françeskanët në mënyrë të veçantë kanë qenë antifashistë edhe antitaliane".

Sipas tij, realiteti nëse nuk u bindet parimeve të ideologjisë do të shkatërrrohet. "Në këtë rast

ideologjia komuniste përballët me fenë, që trajtohet si opium. Duhet gjetur një drogë më e fortë, që të fitojë vetëm njëra. Këtu ka një injeksion të fortë droge. Mos kujtoni se ka mbaruar aty lufta e 1967, vazhdon edhe sot, njerëzit i kemi edhe sot në politikë në të gjitha fushat e jetës, ata njerëz që janë formuar me atë lloj ideologjie", tha Ndreca duke kujtuar se aksioni i 6 shkurtit në vitin 1967 ka qenë i paligjshëm.

"Aksioni i 6 shkurtit 1967 nga pikëpamja ligjore është i paligjshëm. Flas nga pikëpamja ligjore, në atë kohë ata janë hulliganë që hyjnë ashtu nuk ka një bazë ligjore. Vetëm në 1976 me kushtetutën ere do të legalizohet gjithçka. Ligji, durimi, bindja janë fjalë boshe"- shtoi ai.

Studiuesi Adrian Ndreca analizon se si e përcillte propaganda komuniste mbi fenë, kanunin, frikërat, supersticionet dhe zakonet prapanike në këtë film.

Drejtuesja e AQSHE Iris Elezi, së bashku me profesor Ardian Ndreca, folën në detaje punën e bërë, që ideologjia komuniste të injektohej në çdo qelizë të njeriut të ri. Dokumentari tregoi se si vendi ynë kopjoi revolucionin kinez, të rinjtë nga zonat urbane shkuan në zonat rurale për të bindur njerëzit që të hiqnin dorë nga besimi i tyre.

Ata vunë re se përmes artit të bindjes, propaganda jepte efekt e kjo bëhej edhe më e lehtë nëpërmjet konfuzionit. Ndërsa, në fund të referimit profesor Ndreca tha se ai që humbi ishte njeriu e fjalën njeri duhet që të dimë ta theksojmë mirë. Ndryshe i humbasim sensin, humbasim edhe sensin e ekzistencës sonë.

SHFAQJA

Viti 1967 ishte ndër më ven-

ditmarët për diktaturën komuniste. Udhëheqësi Enver Hoxha shpalli Shqipërinë shtetin e parë ateist në botë dhe ndaloi të gjitha praktikatat fetare. Pasi vuajtën për dy dekada, edhe ato pak kisha, xhami dhe teqe të mbetura u mbyllën ose u shndërruan në kinema apo qendra sportive. Priftërinjtë dhe imamët u vunë përballë gjyqeve publike. Duke kopjuar Revolucionin Kulturor Kinez, komunistët e rinj shkuan në të gjithë Shqipërinë që të shkatërronin ndërtesat fetare dhe të bindnin njerëzit të hiqnin dorë nga besimi i tyre. Gjatë kësaj fushate të dhunshme, katër murgj të moshuar vdiqën kur u dogj Kuvendi Françeskan i Shkodrës. Për këto ngjarje të rëndësishme u prodhua një dokumentar kontroversal i titulluar NË FLAKËT E REVOLUCIONIT (1967), me regjisor kamera operatorin e talentuar, Endri Keko. I xhiruar nga mjeshtrit Ilia Terpini dhe Niko Theodhosi, ky dokumentar bardhë e zi, i shfaqur shumë rrallë, sjell në vëmendje këtë moment kyç të historisë së vendit tonë. Drejtuesja e AQSHE, Iris Elezi, së bashku me profesor Ardian Ndreca, hodhën dritë mbi këtë kohë traumatike të Shqipërisë. Takimi u mbajt në mërkurë në mbërmje në "Kinema Agimi". Filmi do të shfaqet në 35mm me titra në anglisht. *P.S. Kurimi i filmit, si dhe kumtesa e Prof. Ardian Ndreca ofrohen falas. Për të përballuar kostot e sallës dhe të projektimit, hyrja kushton 300 L. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit ka rifilluar ciklin "Thesaret e Arkivit" - program i kuruar dhe prezantuar nga personalitete të mendimit dhe hulumtimit bashkëkohor.

Opinion i Ditës

Marrëveshja me ndryshim kufijsh mund të na largojë nga BE

Nga Augustin Palokaj


(vijon nga faqja 1)

... asnjë zgjidhje të caktuar", por ua lënë palëve që vetë të gjejnë zgjidhjen për të cilën pajtohen. Por kur kërkohet nga ta që, për të tingëlluar të besueshëm, të përsërisin qëndrimin shumëvjeçar se "nuk mund të ketë ndryshim të kufijve të Kosovës, as ndarje e as bashkim me ndonjë shtet tjetër, apo pjesë të ndonjë shteti tjetër (siç e thonë edhe Kushtetuta e Kosovës dhe propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit) në BE nuk e bëjnë këtë. Sillen kinse, ata fare nuk janë të përfshirë në diskutime rreth ndryshimit të kufijve, se ata pranojnë secilën zgjidhje, e cila "do të ishte fryt i pajtimit të të dyja palëve, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, sipas standardeve evropiane, e pranueshme për të gjitha shtetet e BE-së, të mos krijonte shtetet një etnike dhe që do të kishin ndikim stabilizues në rajon".

Shumë karakteristika kërkon BE-ja që të ketë "marrëveshja për normalizimin gjithëpërfshirës të raporteve", që e bën edhe më vështirë të arritshme një marrëveshje të tillë. Por përderisa nuk ka ndonjë zë kundër kërkesave që marrëveshja të jetë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, që të jetë sipas standardeve evropiane, që të ketë ndikim pozitiv në rajon dhe e pranueshme për të gjitha shtetet e BE-së, ekziston një opsion, i cili ka ndarë BE-në ashtu siç ka ndarë edhe skenën politike dhe shoqërinë në Kosovë. Fjala është për opsionin e ndryshimit të kufijve, pa marrë parasysh a do të quhej kjo ndarje e Kosovës, shkëmbim territori apo korrigjim i kufijve.

Mungesa kronike e transparencës nga ana e "lehtësuesve në BE", sikurse edhe nga Ekipi tash shtetëror i udhëhequr nga Fatmir Limaj e Shpend Ahmeti, që nuk duan ta sqarojnë a do ta ndihmojnë apo ta pengojnë arritjen e marrëveshjes, e cila do të nënkuptonte ndryshimin e kufijve, ka bërë që të ketë shumë spekulime. Ato që më së shpeshti dëgjohej e që nuk mund "as të konfirmohen, por as të përgënjeshtrohen" janë: "presidentit Thaçi dhe Vuçiq janë duke biseduar për ndryshimin e kufijve", "këtë e mbështet Zyra e Federikës Mogherinit, dhe për këtë po punon Angelina Eichhorst", "këtë e mbështet edhe një pjesë e administratës amerikane", dhe se "Rusia e pret me padurim për intereset të veta që kjo të ndodhë".

Jo vetëm publikun, por duket se Zyra e Mogherinit po i mban në terr edhe disa shtete anëtare të BE-së. Ato shtete, siç na thonë disa



diplomate, tashmë nuk besojnë kur u thuhet se "nuk ka asgjë konkrete rreth marrëveshjes" dhe kanë frikë se një ditë do të zgohen në mëngjes dhe të shohin se si është arritur një marrëveshje dhe të jenë para aktit të kryer.

E nuk janë të paktë ata që druajnë se do të jetë BE-ja ajo që do ta paguajë çmimin kryesor për ndonjë zgjidhje të gabuar, e cila do të krijonte më shumë problem sesa do t'i zgjidhte. E si "e rrezikshme" konsiderohet marrëveshja, e cila do të sillte deri tek ndryshimi i kufijve.

Gjermania është më e zëshmjia, por nuk është e vetmja që është vështirë të kujtohet ndonjë periudhë kur me aq përbufje disa burorokratë të BE-së të kenë folur për qëndrimin e Gjermanisë. Sepse po mendojnë se Berlino po u prish punë, dhe se "pse të jetë Berlino kundër nëse Prishtina dhe Beogradi vetë pranojnë".

Në BE nuk janë të sigurt as rreth qëndrimit amerikan. Edhe pse as nga zyrtarët amerikanë është thënë se duan marrëveshje gjatë

këtij viti, nuk është thënë prerë se cilën zgjidhje duan në mënyrë specifike. Nuk është e sigurt a janë "Brukseli e Washingtoni" që kërkojnë ndryshimin e kufijve apo janë Thaçi e Vuçiq që kërkojnë nga Brukseli e Washingtoni ta mbështesin këtë ide. Por duket se tash nga Zyra e Mogherinit po e kanë më të lehtë bashkëpunimin dhe koordinimin me Washingtonin sesa me Berlinin. Kur kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, kishte përmendur në takim në Bruksel se në dialog duhet të përfshihet edhe Amerika, sepse Kosova po e humb besimin në BE-në, përfaqësuesja e lartë Federikës Mogherini ishte zemëruar shumë. Tash, prej kur si këshilltar për sigurim kombëtar ka ardhur John Bolton, dikur kundërshtar i Pavarësisë së Kosovës, i cili ka shprehur gatishmëri të mbështesë edhe ndryshimin e kufijve, nga Zyra e Mogherinit duket se po punojnë me amerikanët për, siç thonë, "Izolimin e Gjermanisë". Besojnë se në favor do t'u shkojë edhe Brexiti, i cili do bën qëndrimin e Londrës brenda BE-së, e Britania e

madhe po ashtu nuk e mbështet idenë për ndryshimin e kufijve.

Ende nuk mund të dihet me saktësi nëse ideja për ndryshimet e kufijve të Kosovës ka mbështetje më të gjerë në BE apo këtë e mbështet vetëm një grup i ngushtë rreth përfaqësueses së lartë Federikës Mogherini. Një gjë mund të thuhet megjithatë me probabilitet të madh. Nëse dialogu rezulton në një marrëveshje të cilën nuk e pëlqen Gjermania, atëherë edhe Kosova edhe Serbia duhet ta dinë se do ta kenë edhe më të vështirë procesin e integrimi në BE.

Gjermania edhe ashtu e ka fjalën kryesore në procesin e zgjerimit të BE-së. Gjermania ka insistuar që në kornizën negociatave të BE-së për negociatat me Serbinë të hyjë si kusht edhe "normalizimi gjithëpërfshirës i raporteve me Kosovën, përfshirë edhe përmes një dokumenti ligjërisht obligues". Sikur të mos ishte Gjermania ky kusht nuk do të futte fare. Gjermania më së shumti insiston në matjen e saktë të përmbushjes së kriterëve nga ana e Serbisë në procesin e negociatave para

hapjes apo mbyljes së secilit kapitull. Pra, Gjermania më shumë se çilido vend tjetër i BE-së dikton dinamikën e procesit të zgjerimit. Prandaj do të ishte naive për Kosovën dhe Serbinë të besojnë se mund të avancojnë gjatë të tyre për integrim në BE duke arritur një marrëveshje kundër vullnetit të Gjermanisë. Siç u shpreh një diplomat i një shteti anëtar të BE-së: "Nëse dikush beson se mund të avancojë drejt BE-së me ndihmën e Trumpit dhe Rusisë, kundër vullnetit të Gjermanisë, atëherë me fat!".

Procesi i integrit të Serbisë në BE është shumë i ngadalshëm. Për më shumë se gjashtë vjet kanë hapur vetëm 16 nga 35 kapitujt negociatave, ndërsa kanë mbyllur vetëm dy. Kosova nuk e ka bërë as hapin e parë në këtë drejtim. Prandaj, duhet të kenë kujdes që këtë proces për të, edhe ashtu të vështirë, të mos e rëndojnë edhe më me ndonjë marrëveshje e cila do të haptë më shumë çështje sesa që do t'i mbyllte.

Koha.net

Opinion *i* Ditës

A i njolloset më fytyra Ramës?

Nga Andi Bushati

(vijon nga faja 1)

... që ushqejnë një urrejtje "ad personam" kundrejt Edi Ramës, të tjerë, kundërshtarë bazikë të tij, mund të shtrajnë dilemat:

A ishte e nevojshme boja, pas spektaklit me vezë të Endri Hasës dhe goditjes me cizme të Monikës?

A fiton pikë një opozitë politike duke u marrë personalisht me Ramën, gjë që në çdo strategji komunikimi pranohet si një mënyrë për t'u shmangur nga thelbi i politikave të kryeministrit?

A kanë nevojë PD-LSI të ndërmarrin akte të tilla që zakonisht janë mjete të grupimeve të vogla ekstremiste, që i përdorin për të reklamuar idetë e tyre të marginalizuara?

A shton diçka më shumë njollosja fizike e një politikani, kur opozita e ka kapur atë me presh në duar si hajdut, e ka faktuar si vjedhës së zgjedhjeve, e ka vizatuar si bashkëfajtor të oligarkëve?

Ngritja e këtyre çështjeve të shpë në përgjigje dëshpëruese. Ato të bëjnë të mendosh së PD-ja po privilegjon betejën teatrale përpara asaj reale, se goditja me vezë ishte reagim ndaj pafuqisë për të djegur mandatet, se hedhja e cizmes ishte si justifikim ndaj pamundësisë për të bojkotuar zgjedhjet, se shiringa me bojë ishte pavendosmëri për ta lënë Ramën fillikat, mes sistemit të kapur prej tij.

Gjithkush që vret pak mendjen e kupton se një forcë që ka në dorë akte politike (si braktisja përfundimtare e Kuvendit, apo refuzimi për të hyrë në betejën lokale të qershorit) nuk ka pse ndërmerr nisma kozmetike.

Gjithkush që e njeh politikën, e di se me mjekrën e llangosur me bojë, apo me kostumin e përlyer me vezë Edi Rama mund të luajë më mirë rolin e mëshirueshëm të viktimës, sesa po ta lësh atë të duket si autokratit e një vendi, ku partia e vetme e tepsisë ka asgjësuar pluralizmin politik.

Në këtë kuptim, kjo lloj



strategie jo vetëm që nuk jep asnjë rezultat, por ajo varros radikalizmin serioz duke e zëvendësuar atë me protagonizëm fotografik.

Po atëherë, shtrohet pyetja, a ishte i gabuar akti i Palokës? A e dëmton ai kauzën e opozitës?

Boja e hedhur sot në Kuvend, mund të justifikohet vetëm në një drejtim.

As si akt për të njollosur Ramën, sepse tashmë këtë mision opozita e ka përbushur, as si mjet për të treguar se ai është i paprek-

shëm, sepse edhe këtë e ka provuar, por thjeshtë si një gjest, simbolik, për të garantuar ata që do të zbarkojnë në Tiranë në 16 shkurt.

Prej kohësh, tashmë, popullin e opozitës po e bren dyshimi se e gjitha është një lojë, se rolet janë të ndara, se mes kryeministrit dhe kundërshtarëve të tij ka një shkelje të heshtur syri në distancë dhe janë ata që duhen garantuar.

Në këtë kuptim, veprimi i Palokës, mund të përkthehet si shen-

ja, se me këtë kryeministër koha e bashkëjetesës politike ka përfunduar. Se tani ka nisur periudha e konfrontimit fizik.

Vetëm si i tillë, në funksion të betejës së ardhshme, ai do të kish të njëjtin sens. Por ama me një kusht: pa parlament, pa zgjedhje dhe pa një 18 maj të dytë me Ramën. Sepse në të kundërt edhe boja edhe vezët edhe cizmet e flakura në ajër do t'i ngjanin pështymës së hedhur lart, që dihet se ku përfundon.

HOROSKOPI

DASHI

E premija do t'ju sjellë disa fitore të mëdha. Ka gjasa të rriteni në përgjegjësi në punë dhe t'ju rritet rroga. Ata që kanë biznesin e tyre, nuk duhet të braktisin idetë kreative. Rekomandohet të eksperimentoni në biznes dhe në marrëdhëniet tuaja personale.

DEMI

Të lindurit e kësaj shenje duhet të bëjnë kujdes në punë. Është e rëndësishme të tregoni profesionalizëm, pasi kjo mund të rrisë shanset për një takim prestigjioz. Ata që kanë menduar të ndryshojnë vendin e punës, do t'u buzëqeshë fati.

BINJAKET

Binjakët këshillohen të heshtin, pasi mund të bëheni pjesë e një konflikti. Megjithatë, në përgjithësi do të jetë një ditë e qetë. Gjithashtu, ka gjasa që sot t'ju jepni shans një romancë të re, e cila do t'ju falë emocione pafund.

GAFORJA

Kjo e premte nuk premtan të jetë dita juaj e duhur. Do të vini re indiferencë nga ana e miqve të ngushtë ose e partnerit/partneres suaj. Do të bënit mirë të kryenit aktivitetet që ju dëshironin, në mënyrë që të çlirohni nga stresi.

LUANI

Do të përfaton një gjendje të paqëndrueshme emocionale. Megjithatë, kjo nuk do të zgjasë shumë. Sa i përket anës financiare, do të jetë dita e duhur. Përgjithësisht dita do të kalojë lehtë, pa ndonjë ngjarje dramatike.

VIRGJERESHA

Virgjreshat rekomandohen që të shmangin zhvillimin e ndonjë bisede serioze. Mund të përfshihen në problemet e dikujt tjetër. Përgendrohuni të vetja dhe të prioritetit tuaj. Përpunoni fort që të përfundoni një projekt të rëndësishëm, që keni nisur.

PESHORJA

Disa Peshore do të kenë dëshirë të relaksohen gjatë kësaj të premteje, duke marrë parasysh punën e lodhshme që ju keni bërë gjatë javës. Kjo ditë është ideale për tu relaksuar dhe për të qëndruar me të afërmit tuaj. Për ata që nuk mund ta shmangin punën sot, kërkoni ndihmën e të tjerëve.

AKREPI

Të lindurit e kësaj shenje do të kalojnë një ditë vërtet të këndshme. Propabiliteti për takime romantike është i lartë. Ndoshta dikush do të gjejë partnerin perfekt për të ngritur një biznes. Fat i mirë parashikohet edhe në çështjet financiare.

SHIGJETARI

Shigjetarët do të arrijnë aty, ku të tjerët nuk mundin sot. Ndoshta kjo i referohet faktit që mund të mësoni një informacion sekret. Por mund të krijoni edhe një lidhje të romantike, në bazë të njohjeve të reja.

BRICJAPI

Disa Bricjapë do të punojnë këtë të premte shumë se ditët e tjera. Ka gjasa që të përballeni me një konflikt në familje. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia për të kaluar një mbrëmje të këndshme nën praninë e partnerit/partneres suaj.

UJORI

Do të jetë një ditë e mbushur me shqetësime. Rrezikoni që një konflikt me një nga të afërmit tuaj të përshkallëzohet, por mund të bëhet fjalë edhe për një problem financiar. Mos hezitoni të kërkoni ndihmë nga ata persona që ju i besoni.

PESHQIT

Do të jetë një ditë përgjithësisht monotone. Do të ishte e udhës që të shmangnit rutinën e përditshme. Mos lejoni problemet të dominojnë mendimet tuaja. Bëhuni optimistë për t'i parë gjërat me sy tjetër dhe për të ecur përpara.

TRAJNERI I TEUTËS

Bledi Shkëmbi është i bindur te fitorja këtë të premte ndaj Kukësit, ndonëse shpreson që të ketë dhe fatin me vete, fat që u duk se e kishte braktisur skuadrën durrsake në ndeshjet e fundit. Teuta është në luftë për vendin e dytë dhe që ta marrë këtë vend, duhet të mposhtë pikërisht ekipin e Armando Cungut. "Nuk kemi qenë aty ku duhet



Shkëmbi: Na duhet dhe pak fat për të mposhtur Kukësin

javën e fundit. Me Flamurtarin dhe Tiranën nuk ishim mirë në lojë, ndërsa me Kamzën nuk arritëm të shfrytëzonim rastet që krijuam. Nuk patëm edhe fat në ndeshjen e fundit. Po vuajmë finalizimin në javët e fundit, ku nuk kemi mundur të shkojmë te fitorja.

Nuk duhet ta përritojmë keq situatën, sepse të gjithë e dimë se i kemi mundur të kthehemi në nivelin e duhur. Shpresoj ta bëjmë që këtë javë, me ndihmën e fatit," u shpreh timonieri koççar për "Supersort". Kukësi është një kockë e fortë, por Shkëmbi beson te Latif, go-

lat e të cilit i kanë munguar ekipit. "Nuk është se kemi ndryshuar në grup, vetëm Arapi po luan nga ata që erdhën në merkaton e dimrit, është po ajo Teutë. Presim që Latif të kthehet në formën e tij më të mirë. Kukësi? Patjetër që është shumë e vështirë, sepse luajmë ndaj një ekipi që pretendon titullin. Ne thjesht duhet të bëjmë atë lojë që kemi bërë më parë, kur kemi marrë rezultate pozitive".

Trajneri i Kukësit shpreson të rikuperojë pikë ndaj Partizanit, teksa beson tek ekipi i tij

Cungu: Jemi ende në luftë për titullin

Ndaj Teutës është prova e së vërtetës për shkodrëranin



Jeton Selimi

Armando Cungu nuk ka ndër mend të ngrejë flamurin e bardhë. Shkodrani, që e ka parë veten në një presion shumë të madh në javët e fundit, beson se Kukësi i tij i ka të gjitha shanset për të rikuperuar, njëjtë siç bëri edhe në pjesën e parë të sezonit. "Kemi qenë edhe 12 pikë larg Partizanit në 2 fazat e para dhe te gjithë thanë që kampionati ishte i mbyllur. Futbollit i tillë është, si kemi gabuar ne, mund të gabojnë edhe kundërshtarët tanë. Ne do të mundohemi të marrim maksimumin, atë që është e mundur në çdo ndeshje", tha Cungu në konferencën e zakonshme për shtyp përpara ndeshjes. "Llogaritë janë shumë të thjeshta për ne, kërkojmë maksimumin në çdo ndeshje, kjo është e vetmja llogari që të bëjmë. Nuk më intereson si shkojnë kundërshtarët, të bëjmë punën tonë e të marrim maksimumin për çdo sfidë. Kjo është e rëndësishme për ne", tha tekniku i Kukësit. Trajneri ka



planifikuar të bëjë ndryshime në formacion, por të gjithëka të hapur deri në momentet e fundit. "Do të shohim nesër në fushën e

lojës, nuk më pëlqen të flas para, do të shohim në stërvitjen e fundit. Edhe unë kam idetë e mia, mund të jenë edhe bashkë Rexhi-

naldo me Shkurtajn, e rëndësishme është që kushdo të zbrësë në fushë, të japë maksimumin", përfundoi timonieri shkodrëran

SUPERLIGA	
JAVA E 22-të	
TË PREMTEN	
Teuta - Kukësi	18:00
TË SHTUNEN	
Tirana - Luftëtari	17:00
TË DIEËN	
Kamza - Kastrioti	14:00
Laçi - Partizani	14:00
Flamurtari - Skënderbeu	17:00

i verilindorëve. Kukësi ka vetëm një mundësi ndaj Teutës. Olsi Teqjan, i cili ka plotësuar numrin e kartonëve të verdhë. Mbrojtësi është ndëshkuar në dy ndeshje me Tiranën, ndërsa me Kukësin ka marrë kartonë të verdhë ndaj Tiranës e Flamurtarit. Sakaq, e gjithë pjesa tjetër e futbollistëve janë në gjendje të mirë dhe nuk kanë probleme dëmtimesh.

TIRANA

Mema rigjen më në fund sulmuesin e munguar

Namdi Oduamadi me të gjitha gjasat do të jetë në Tiranë në fund të muajit për të nisur stërvitjen. Lajmi konfirmohet nga burime zyrtare bardheblu. Lojtari po vazhdon riافتësimin në Itall, por mendohet se do të jetë gati në fund të muajit. Klubi është duke planifikuar kthimin e tij në klub. Kujtojmë se Oduamadi u dëmtua në sfidën e fazës së parë me Laçin. Mesfushori nxori shpatullën, kaloi një operacion shumë delikat, nga i cili rrezikoi edhe jetën. Nga marsi lojtari do të jetë nën urdhrat e Ardian Memës, i cili do të ketë një futbollist më shumë në organikën e tij. Gjithsesi, klubi më parë duhet të vendosë për kthimin e tij në kryeqytet.



Arsenali turpërohet në Bjellorisi, Interi është "ok" dhe pa Ikkardin

Dje janë luajtur ndeshjet e orës 18:55 të vlefshme për Ligën e Europës, ku nuk kanë munguar rezultatet befasuese. E tillë është humbja e Arsenalit në Bjellorisi, ku Bate Borisov ka fituar me rezultatin e ngushtë 1-0. Golin e vetëm të takimit e shënoi Dragun në të 45-ën, ndërsa "Topçinjtë" e kanë mbyllur me 10 vetë sfidën pas daljes me karton të kuq të Lakazet. Humbet edhe Lacio e Strakoshës. Sevilja ka triumfuar 1-0 falë golit të Ben Jeder në të 22-ën, me spanjollët që kanë dominuar italianët, që në këtë sfidë kishin mungesa të shumta. Interi nuk ndikohet nga telasheet e Mauro Ikkardit dhe gjunjëzon Rapidin e Vjenës falë golit të Lautaro Martinezi në pjesën e parë, me argjentinasin që ekzekutoi saktë nga 11 metrat.

Pambukun: FSHF është një maskaradë

Tronditet Kategoria e Parë, Tomori braktis garën!

Tomori e ka bërë fakt kërcënimin e një dite më parë. Klubi nga Berat, nëpërmjet një konference për shtyp të zyrtarit të tij, Alban Pambukut, ka akuzuar Federatën Shqiptare të Futbollit si një institucion maskaradë dhe që transformon të vërtetën nëpërmjet Komisionit të Disiplinës. "Kjo është një maskaradë e kurditur nga disa pseudozyrtarë dhe e servitur me logën e FSHF-së, si delegati Petrit Haxhia dhe gjyqtari Helidon Halo dhe vetë institucioni i këtij futbollit. Vazhdimisht kanë dashur të na diskriminojnë, në çdo aspekt me kukullat me kur-




disje. Nuk ia kanë dalë, ndaj e vetmja mundësi ishte Komisioni i Disiplinës, që është kthyer në një institucion qesharak dhe korruptiv që dëmton imazhin e futbollit shqiptar. Vendimi i disiplinës ishte një akt i paprecedent. Vetëm një organ i tillë mund të transformojë të vërtetën në ditën me diell duke i shërbyer palës që ka hapur thesin për ta ushqyer", - tha ndër të tjera Pambuku, me Tomorin që po bëhet gati të padisë zyrtarët

Tifozët duken pranë fitores

Gjermanët, gati të legalizojnë piroteknikën në stadione

Prej shumë vitesh flakadanët e dhe fishekzjarrët janë cilësuar në stadione të ndryshme si "armiç" të futbollit. Por përsëri, thuhet në çdo ndeshje, tifozët nedin të tilla duke treguar se e cilësojnë pjesë të kulturës së festimeve në futboll. Për këtë arsye, te klubi i Hamburgut, një nga më të njohurit në Gjermani, po mendojnë që të dërgojnë si propozim në Federatën Gjermane legalizimin e tyre sipas disa normave. "Duhet ta trajtojmë këtë çështje me një këndvështrim tjetër. Sanksionimi i tyre si shkelje nuk është se ka zgjidhur situatën, përkundrazi", shpjegoi presidenti i Hamburg, Bernd Hofman. "Nëse merr në konsideratë faktin se materialet piroteknike kanë qenë rregullisht në stadione në 20 apo 30 vitet e fundit, atëherë duhet pranuar se tashmë janë pjesë e kulturës së tifozëve gjermanë. Nuk ka rëndësi nëse mendon se është mirë apo keq, gjërat janë kështu", tha ai. Në stadiumet gjermane, shfaqjet piroteknike janë shumë të shpeshta, edhe pse janë të ndaluara me rregullore dhe u sjellin vazhdimisht sanksione klubeve.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Immanuel filozof.
- Parashtesë për këteje.
- Argento aktore.
- Gjysmë erotik.
- Janë mence pa kufij.
- Rastet pa set.
- Në mes të dhomës.
- Rrappo pa çifte.
- Gardner aktore.
- Charlie Mingus.
- Janë pjesë të antenës.
- Eshtë e tregut në kapitalizëm.
- Eshtë lojtari underi 21.
- Janë njëvendëshe në Formula 1.
- Qarkullon vetëm në shqipëri.
- Ishin komandantët si Çerçiz Topulli.
- Kishte 100 porta.
- Në krye të aktorëve.
- Gjysma e sllitës.
- Inicialet e Reitman.

- Nganjëherë nuk e vlem qiranë.
- Një ishull si Bikini.
- Nisin nga kreu.
- Një satelit i Uranit.
- Janë kapo.
- Shahu i fundit.
- Janë klasike me tutu.
- U printe hunëve.
- Në fund djathtas.
- Instrumenti i Ravi Shankar.

VERTIKAL

- Një së larti bëhet me stilin fosbury.
- Kaçaturian kompozitor.
- Kush nuk di mbytetë.
- Inicialet e Harris aktore.
- Një tabu islamike.
- Ka satelit Ariel
- Dy asa.
- Kështu janë mbrojtjet e palëvizshme.
- Mund të skadojë.
- Eshtë edhe ajo zanore.
- Ishite futbolli të Holandës.
- Ishin bakantet.
- Janë garat me gregarë.
- Një njëvjeçar.
- Tekat pa kufij.
- Një ekip i Kazanit.
- Fillojnë aksionin.
- Eshtë hidrokarbur.
- Gruaja e Ben Hur.
- Skuadër greke.
- Barack në shtëpinë e bardhë.
- Capirossi i MotoGP.
- Nuk i tregohen babait.
- Mund të jete fetar.
- Jessica aktore.
- Marsi i akejve.
- Tri të parat në klasifikim.
- Gjysmë tatimi.
- Mbyllin fushata.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Eshtë hokatari.
- Loja me full.
- Kaas këngëtare.
- Përdoret kundër malaries
- Këndohet në opera.
- Pak formalitete.
- Eshtë legjenda.
- Të fundit konak.
- I mbjell... katastrofa.
- I bëjnë të luajturit.
- Fillojnë mpirjen.
- Janë trupa qiellore.
- Qendër në kaos.
- Preferojnë yjet e hënën.
- Tri të parat në atletikë.
- Beton pa kufij.
- Ente Autonome Tiranë.
- Një metër në kufij.
- Një stacion... anijesh.

VERTIKAL


- Catherine aktore.
- Një vijë e lakuar.
- Tatim pa kufij.
- Lidhet në... fytyr.
- Inicialet e Camus.
- Në kokë të xixëllonjës.
- Fillojnë hapur.
- Kishin flamur të zi.
- Ndezur në aparaturë
- U shkrua nga Kipling.
- Janë mistere për t'u zgjidhur.
- Rastet pa set.
- Ai ekzekutiv tani është bashki.
- Eshtë edkumi në palestër.
- Grandi aktore.
- Eshtë gjarpër.
- Një pëlhurë sintetikë.
- I bëjnë testet me një set.
- Një monument... për kujtim.
- Atdheu i Papa Eoçjyla-s.
- Mund të jenë me katër kohë.
- Një ushtarak me... numër.
- Emri i Salacrou.
- Telefoni në kartëvizitë.
- Numri i oktetit.
- Kukulla e Ibsen.
- Thyhet me dy kafshata.
- Rajone Autonome Lokale.
- Ekstrema në eskreme.
- Mbyllin një manastir.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		7				5		8
			2					
5	6							3
		9	8		6	7		
		8		5		4	2	
		3	4	8				5
2	8		4	3				1
			6			9		2
			7					

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	5	4	7	2	1	8	9	3
1	8	7	9	3	6	4	5	2
9	2	3	4	8	5	6	1	7
4	9	8	2	5	3	7	6	1
7	3	1	8	6	9	2	4	5
2	6	5	1	4	7	9	3	8
5	4	6	3	7	8	1	2	9
3	7	9	6	1	2	5	8	4
8	1	2	5	9	4	3	7	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Dashuria pyet miqësinë: "çfarë po bën atje?"
Miqësia i përgjigjet: "bëj të qeshin ata që ti i bën të qajnë."

- Lëre zemrën tënde të rrahi vetëm për ata që mund ta dëgjojnë.

- Mos i harxhoni fjalët tuaja për njerëzit që meritojnë heshtjen tuaj. Ndonjëherë më e mira që duhet të ofrojmë, është heshtja.

- Vetëm ata që janë të interesuar për ju, mund t'ju dëgjojnë kur heshtni.

- Shumë njerëz do trembeshin nëse në pasqyrë, në vend të fytyrës së tyre, do të shikonin karakterin e tyre...

Thënie të mençura

- "Mirësia e babait është më e lartë se mali, dashamirësia e nënës është më e thellë se deti".
- Nëse prindërit kanë të drejtë të kenë fëmijë, dhe fëmijët kanë të drejtë të kenë prindër.

- Koha vendos se kë do të takojmë në jetën tonë, zemra vendos se kë duam në jetën tonë dhe sjellja jonë vendos se kush do të qëndrojë në jetën tonë.
- Gjembat që të lënduan ishin ato që u përpoqe t'i mësosh të çelën lule.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	L	E	X	S	G	P	O	A	Z	I	
M	I	S	H	N	D	O	R	E	S	H	R
A	R	A	M	O	G	O	A	U	T	O	
M	K	I	M	N	O	V	A	K	O	N	
T	S	E	R	I	A	L	I	A	R	T	I
P	R	E	T	E	N	D	I	M	I	O	K
R	O	N	A	L	D	O	I	G	A	E	
M	A	L	E	N	G	O	R	E	T		
H	A	T	A	R	I	A	C	E	R	O	R
I	R	O	N	A	C	E	M	Y			
L	O	I	R	A	C	O	R	O	R	K	N
F	A	L	L	I	K	F	S	D	O	R	A
A	D	A	M	P	A	L	I	M	I	N	
L	E	M	T	A	B	E	L	A	T	I	T
A	T	K	A	P	I	T	U	L	E	M	I
N	M	A	R	I	N	A	R	I	I	L	
G	R	E	M	I	N	A	U	E	F	E	
A	R	I	F	D	E	N	T	I	S	T	
P	I	K	A	T	E	S	E	R	T	E	
C	I	T	A	T	E	M	E	T	O	R	E
O	S	Z	R	A	M	T	R	I			
S	H	T	E	P	I	T	E	L	E	J	A
A	E	K	A	M	I	V	I	S	A	R	I

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

7	2	13	8	11	1	17	5	2	4	1	3	
18	17	2	5	1	3			3	1	4	6	
13	3		8		7	K	2	11	1	8	1	3
10	1	3	6	12	9	O	5	1	3	13	18	
4	1	1	7	9	13	N	9	12	6	2	8	
6	15		8	9	7	6	I	12	1	3	7	8
2	5	6	2	13	2	2	3	2	2	2	6	
12	1	13		1	16	3	8	2	3			
2	18	2			6	6	8	6	5	1	3	
13			18	2	13	2	7	2	1	7		
3	1	1		12	2	7	1	3	13	1	3	
6		4	5	6	3	2	6	4	1	3	1	

A	R	T	M	K	R	I	M	B	A	T
N	G	U	J	I	M	U	A	N	E	
I	B	A	N	I	M	K	H	M	E	R
J	H	K	A	N	I	B	A	L	E	T
E	B	O	T	E	R	O	R	E	T	
L	A	B	O	R	A	T	O	R	E	T
H	A	I	R	V	A	N	O	R		
R	E	N	E	A	N	T	R	E	H	
A	V	E	T	V	I	I	I	G	U	
K	A	N	T	M	E	K	T	I	N	
U	T	I	B	E	T	A	T	E	M	E
J	R	R	U	G	A	A	R	T	E	T

